



• ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE
NEWSLETTER
TETOR 2005, Nr 19

A photograph of four individuals in professional attire. In the foreground, a man with glasses and a grey suit is smiling. Behind him stand two other men in suits, one with a red tie and one with a striped tie. To the left, a woman in a black blazer and glasses is looking towards the camera. The background shows a wooden interior, possibly a hallway or a meeting room.

**“Kuvendi duhet ta mbikëqyrë
punën e qeverisë
si dhe implementimin e
legjislacionit”**

Editoriali

Botimi aktual, tematik, i Buletinit ASI përqendrohet në mbikëqyrjen parlamentare të qeverisë. Në këtë Buletin kryesuesit e disa komisioneve i bëjnë të njohura përvojat dhe pikëpamjet e tyre. Ndërkaq, ekspertë përbrenda Kuvendit dhe nga organizatat partnere të ASI-t i ofrojnë analizat e tyre. Gjatë mandatit të dytë të Kuvendit të Kosovës, mbikëqyrja e qeverisë është bërë një nga çështjet kryesore e procesit politik. Siç është vërejtur gjatë tryezës së rrumbullaktë parlamentare të Evropës juglindore të mbajtur së voni në Prishtinë, mbikëqyrja parlamentare është bërë çështje thelbësore edhe për parlamentet e tjera të rajonit.

Kuvendi i Kosovës ka zhvilluar debate mbi përgatitjet për biseda lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës. Me aktin e dorëzimit të raportit nga z. Kai Eide Sekretarit të përgjithshëm të KB-ve z. Kofi Annan, zhvillimet politike në Kosovë janë përshpejtuar. Ky Buletin i ASI-t ofron një pasqyrë mbi ngjarjet e fundit në institucionet e Kosovës, që në një masë të madhe kanë të bëjnë me procesin e statusit.

Shpresojmë se këto informata do të jenë të dobishme për ju. I mirëpresim reagimet tuaja.

*Franklin De Vrieze,
Kordinator i "Initiative për Përkrahje të Kuvendit"*

2. Editoriali

Franklin De Vrieze

3. "Kuvendi duhet ta mbikëqyrë punën e qeverisë si dhe implementimin e legjislacionit"

Interview with Assembly Committee Chairpersons

7. Mbikëqyrja efektive parlamentare kundruall tundimeve totalitare

Senator Norica Nikolai

8. Standardet dhe statusi - rruga përpara

Eugen Wollfarth

9. Zhvillimet e fundit në institucionet e Kosovës**13. Ligjet e proceduara dhe të miratuara në Kuvendin e Kosovës****17. "Detyra ime është të mos i besoj qeverisë"**

Interview with Naser Osmani

18. Roli i Misionit të OSBE-së në Kosovë

Kara Johnston-Molina

20. Përputhja e legjislacionit të Kosovës me legjislacionin evropian - EU

Acquis Communautaire

Venera Hajrullahu

21. Përmirësimi i mbikëqyrjes së ekzekutivit në Kosovë

Edmon Efendija

22. Mbikëqyrja parlamentare e Ministrisë së re të Punëve të Brendshme

Peter Vanhoute

24. Instrumentet parlamentar për mbikëqyrjen e punës së ekzekutivit

Virtyt Ibrahimaga

27. Mbikëqyrja e Ekzekutivit të Komunës nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Silvia Eckert

**Vetëdija dhe legjitimiteti**

"Marrëdhëniet midis parlamenteve dhe qeverive janë kryesore. Zakonisht, kur nuk kemi Parlament të mirëfillët, qeveritë e monopolizojnë politikën, jo vetëm në këtë pjesë të Evropës, por edhe në vende të tjera. Kështu që, qeveritë janë të prira të harrojnë se në të vëtetë në shoqëritë demokratike Parlamenti është organi më i lartë i pushtetit, e jo Qeveria, ngase deputetët e përfaqësojnë popullin. Së këtejmi, Parlamentet kanë një detyrë mjaft të rëndë që t'ua rikujtojnë qeverive rëndësinë dhe peshën që kanë marrëdhëniet e ekuilibruara midis qeverive dhe parlamenteve.

Qytetarët, të cilët i zgjedhin deputetët e tyre presin nga ta që jo vetëm ta zhvillojnë legjislacionin e ri, por të edhe të shërbejnë

si gurthemel i kontrollit demokratik të funksionimit të institucioneve demokratike. Ndaj ata duhet të reflektojnë për problemet me të cilat njerëzit ndeshen.

Për ta kontrolluar dhe për ta mbikëqyrur punën dhe funksionimin e qeverisë, deputetët mund të mbështeten në instrumentet formale, por edhe në një mori instrumentesh joformale. Prandaj, një nga qëllimet më të rëndësishme të kësaj tryeze të rrumbullakët është se si të mësojmë që t'i shfrytëzojmë të dy këto instrumente, në mënyrë efikase, për të ushtruar një kontroll efikas mbi qeverinë pa e penguar funksionimin e sistemit.

Gjatë përvojës sime 20 vjeçare si diplomat gjerman, kam vërejtur se deputetët në mbarë botën janë të vetëdijshëm dhe koshientë për rolin e tyre, për faktin se ata janë të zgjedhur, kanë një mandat dhe kanë legjitimitet.

Deputetët e parlamenteve, më shumë se qeveritë, kanë mundësi që të diskutojnë për probleme, larg nga mediat, por edhe larg nga presionet e grupeve të interesit për të kërkuar zgjidhje të përbashkëta dhe për të hartuar strategji, që do t'i shërbejnë jo vetëm interesave personale apo lokale por edhe interesave të përbashkëta dhe të gjithë rajonit."

Fjala e Ambasadorit Werner Wnendt, Shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, me rastin e hapjes së punimeve të Tryezës Parlamentare të Evropës Juglindore, në Prishtinë me 9 qershor 2005.

“Kuvendi duhet ta mbikëqyrë punën e qeverisë si dhe implementimin e legjislacionit”

Intervistuar nga Edita Buçaj dhe Blerim Vela, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Më 15 shtator 2005, Misioni i OSBE-së në Kosovë i ka ftuar gjashtë kryesuesit e Komisioneve të Kuvendit për ta diskutuar kontrollin parlamentar të degës ekzekutive të qeverisë si mekanizëm demokratik. Pjesëmarrës në këtë debat të gjallë ishin znj. Nekibe Kelmendi (LDK) nga Komisioni për shërbime publike, z. Hydajet Hyseni (PDK) nga Komisioni për çështje ligjore, gjyqësore dhe të kornizës kushtetuese, z. Naim Maloku (AAK) nga Komisioni për gatishmëri dhe emergjencë dhe z. Rifat Krasniqi (KDTP, 6+) nga Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor. Fatkeqësisht, znj. Fatmire Mulhaxha-Kollçaku (ORA) dhe z. Rangjel Nojkiq (SLKM) nuka mundën t'i bashkangjiten debatit për arsye të ndryshme. Kjo është hera e parë që kryesuesit e komisioneve të Kuvendit në mënyrë publike e adresojnë çështjen e kontrollit parlamentar. Kjo publikohet si pjesë e botimit special të buletinit ASI që i kushtohet kontrollit parlamentar.

ASI: Znj. Nekibe Kelmendi, si e përkufizoni ju kontrollin parlamentar?

N. Kelmendi: Mendoj se kontrolli parlamentar është shumë i rëndësishëm për punën e Kuvendit, sidomos për arritjen së atyre qëllimeve të cilat i ka promovuar gjatë fushatës elektorale qeveria. Mua do të më bënte përshtypje të shoh se qeveria do të jetë në



gjendje t'i zbatojë premtimet më esenciale që janë dhënë gjatë fushatës zgjedhore. Nga kjo perspektivë ne duhet ta kontrollojmë punën e qeverisë.

H. Hyseni: Kontrolli parlamentar dhe implementimi i ligjeve sipas mendimit tim janë komponentat kryesore të një parlamenti që funksionon në mënyrë adekuate dhe (janë vitale për) marrëdhëniet midis legjislativit dhe ekzekutivit. Parlamenti ka shumë funksione, dy nga të cilat janë më të rëndësishmet: hartimi dhe miratimi i ligjeve, zbatimi (i ligjeve) dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre. Për shkak të specifikave të Kosovës, institucioneve të saj dhe vakuimit institucional e ligjor, ky funksion ende nuk e ka arritur formën e vet përfundimtare. Për këtë arsye

kjo mbetet një nga sfidat për të ardhmen.

ASI: Z. Naim Maloku, si e shihni ju rolin e komisioneve në kontrollin ndaj qeverisë?

N. Maloku: Është thelbësore që komisionet parlamentare të ushtrjnë kontroll ndaj ministrive relevante. Komisionet janë të përbëra në atë mënyrë që komisionet e caktuara janë kompetente ndaj dy apo tri ministrive, ose merren me çështje që kanë të bëjnë me dy ose më tepër ministri. Unë vlerësoj që Kosova ende gjendet në fazën e instalimit të kontrollit parlamentar, në fazën e marrjes së përvojave dhe themelimit të sistemit të mirëfilltë të kontrollit parlamentar mbi punën e qeverisë. Ne po bëjmë përpjekje dhe ne

jemi në rrugë të mirë drejt ushtrimit të kontrollit të plotë, (ndonëse) me numër të redukuar të komisioneve në krahasim me mandatin e mëparshëm. Gjithashtu, gjatë këtij mandati ne kemi ndarje normale në pozitë dhe opozitë. Kjo implikon faktin se kemi kontroll të dyfishtë: kontrollin e komisioneve parlamentare dhe kontrollin e punës së qeverisë nga ana e opozitës.

R. Krasniqi: Kontrolli parlamentar është funksioni kryesor i komisioneve, që nga afër të monitorohen ministrinë në nxjerrjen e akteve nënligjore, dhe implementimi i ligjeve të miratuara në Kuvend. Dhe kjo ka fillua të shprehet më tepër në këtë mandat legjislativ.

ASI: Znj. Nekibe Kelmendi, çfarë është përvoja e komisionit tuaj lidhur me kontrollin parlamentar?

N. Kelmendi: Komisioni ka monitoruar punën e Ministrisë së pushtetit lokal dhe Ministrisë së shërbimeve publike, por jo në mënyrë të plotë për shkak të mungesës së kompetencave. Kontrolli është bërë përmes ftesave për pjesëmarrje në punën e komisioneve dhe raportimit për ligjet, si mjet për t'i bërë ligjet më efektive. Ne i kemi monitoruar ato përmes bashkëpunimit, përkatësisht përmes debateve publike me shoqërinë civile, UNMIK-un dhe përfaqësuesit e qeverisë, me qëllim të ngritjes së

vetëdijes së opinionit publik për për çështjet ose ligjet e caktuara. Në legjislaturën e kaluar, Komisioni ka ftuar ministrin por ai kurrë nuk ka marrë pjesë. Në vend të tij në Komision janë dërguar zyrtarë të rangut të dytë. Shpresojmë se kjo nuk do të përsëritet. Kur Kuvendi dhe komisionet të fillojnë punët për çështjet me rëndësi për shoqërinë kosovare, ministrat e ftuar do të marrin pjesë dhe do të raportojnë.

ASI: Z. Hydajet Hyseni, si e trajton Komisioni për çështje ligjore, gjyqësore dhe të kornizës kushtetuese këtë problematikë?

H.Hyseni: Komisioni i ka identifikuar aktivitetet e ardhshme në zbatimin e ligjeve dhe mbikëqyrjen e zbatueshmërisë institucionale të ligjeve. Komisioni në bashkëpunim me partnerët e vet së shpejti do ta bëjë një vlerësim të funksionit të mbikëqyrjes dhe të gjejë mënyrat e ushtrimit të kontrollit adekuat mbi ekzekutivin. Megjithatë, më duhet ta theksoj se ne ballafaqohemi me shumë probleme siç janë mungesa e përvojës demokratike parlamentare, përvoja e keqe kvazi-parlamentare dhe, që është më me rëndësi, vakuumin institucional dhe ligjor. Në shumë fusha struktura e ekzekutivit në Kosovë është jo e plotë; p.sh., neve na mungon Ministria e drejtësisë, Ministria e punëve të jashtme, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e mbrojtjes, etj. Kjo është një situatë kontraverze kur kemi parasysh faktin se Kosova në të kaluarën ka pasur një strukturë ekzekutive ekuivalente me ish republikat jugosllave. Për këtë arsye, Kosova i ka

pasur këto pushtete, atë që në terminologjinë ligjore njihet si 'droit aquis'. Dhe çfarëdo vonese në këtë drejtim nuk është e justifikueshme.

Mbikëqyrjaparlamentare është e mundshme me institucione përgjegjëse ndaj parlamentit. Por komisioni të cilin e drejtoj unë e ka ngritur këtë çështje dhe ka kërkuar debat të hapur me përfaqësuesit e Shtyllës së I-rë të UNMIK-ut – zyren ligjore, departamentin e drejtësisë, zyren ligjore të zyres së Kryeministrit, dhe ekspertë të tjerë nga ministri të ndryshme. Të gjithë iu kanë përgjigjur ftesës dhe janë paraqitur nisma me rëndësi në këtë drejtim. Është vendosur një bashkëpunim dhe komunikim i qëndrueshëm, gjë që është premtuese për punën në të ardhmen.

Ne po punojmë në projektligjet për gjykatat, projektligjin për prokurorinë dhe ligjet e tjera përkatëse që u shërbejnë ose janë të lidhura me këto ligje themelore. Ne gjithashtu po ndërmarrim nisma ligjore për hartimin e ligjit për hetime parlamentare dhe ligjin për ombudspersonin. Ne nga qeveria i kemi kërkuar projektligjet që mungojnë në programin legjislativ të qeverisë. Ne jemi përqendruar në zbatimin e ligjeve relevante për vet natyrën e komisionit tonë. Ne kemi vështirësi pasi që këto fusha janë të rezervuara dhe çfarëdo aktiviteti në këtë drejtim shihet si opsional, jo i obligueshëm, dhe kjo paraqet vështirësi. Megjithatë, kjo funksionon. Ne besojmë se shumë shpejtë kjo do të rezultojë me informata të mëtejshme ose me ndonjë raport lidhur me situatën në gjyqësor sa i përket implementimit të ligjeve. Unë besoj se kjo do të



Znj. Nekibe Kelmendi

ndihmojë në ndërtimin e një realiteti të ri institucional dhe ligjor në fushën e rëndësishme të gjyqësorit.

ASI: Z. Naim Maloku, çfarë është përvoja e Komisionit për gatishmëri dhe emergjencë në këtë aspekt?

N. Maloku: Së pari desha të përmend përvojën gjatë mandatit të kaluar në Komisionin për mjedis dhe planifikim hapësinor. Komisioni ka pasur qasje të mirë në punën e ministrisë, jo vetëm të ministrit por në të gjitha departamentet, qoftë me ftesat të cilave iu ka përgjigjur ministria dhe të cilat ia ka bërë komisioni ashtu edhe me vizitat që kemi pasur në ministri. Për momentin, Komisioni për gatishmëri emergjente ka ingerenca mbi departamentin për gatishmëri emergjente që është në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike, shefi i të cilit është ftuar para komisionit për ta prezentuar në tërësi situatën në departament. Gjithashtu, Komisioni është i njoftuar

me planin zhvillimor të departamentit për pesë vitet e ardhshme. Pra kemi mbikëqyrje të plotë në këtë departament. Pasi që përgjegjësitë e këtij Komisioni kalojnë pak edhe në TMK, dy herë kemi pasur kontakte me Zyrën për Koordinim të TMK-së. Para komisionit është prezentuar i tërë funksionimi i Zyrës për koordinim të cilën e udhëheq gjenerali Balfur dhe e tërë puna e deritanishme si dhe projektet zhvillimore. Komisioni është njoftuar edhe me zhvillimet brenda TMK-së, siç janë brigadat për mbrojtje civile.

ASI: Z. Krasniç, çfarë është bashkëpunimi juaj me ministrinë përkatëse?

R. Krasniç: Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor koordinon punën me dy ministri të cilat janë në fushëveprimin e vet. Komisioni ka hartuar një listë problemesh për shqyrtim që janë gjithashtu edhe prioritete të ministrive përkatëse. Komisioni gjithashtu ka pasur edhe

vizita në terren në komuna së bashku me përfaqësuesit e ministrisë përkatëse. Për më tepër, komisioni ka kërkuar prej qeverisë zgjidhjen e problematikës së caktuar në atë komunë të cilën e viziton komisioni. Gjatë vizitës tentojmë që të ndikojmë në zgjidhjen e problemeve. Sa i përket legjislacionit bashkëpunimi është në nivel të duhur me dy ministrinë. Përfaqësuesit e ministrive rregullisht ftohen në mbledhjet e komisionit ku bashkërisht me komisionin bëjnë hartimin e amandamenteve. Gjithashtu, Komisioni ka kërkuar evidencën e akteve nën-ligjore të cilat i kanë nxjerrë dy ministrinë.

ASI: Z. Hyseni, ju përmendët vakuumin ligjor dhe mungesën e akteve nën-ligjore. Sae vështirëson kjo punën e komisionit tuaj dhe a keni marrë ndonjë iniciativë që t'i bëni kërkesë kuvendit që të bëhet diçka në këtë aspekt? A ekziston mundësia që mungesa e akteve ligjore t'i jap dikujt mundësi që të bëjë interpretim krejt tjetër prej asaj që është në ligj?

H. Hyseni: Në fillim dëshiroj të theksoj se zbatueshmëria e ligjeve duhet të jetë komponentë që duhet ta përcjellë gjithë procesin e hartimit dhe miratimit të ligjeve. Do të thotë ligjet kur të hartohen dhe të miratohen duhet të mendohet dhe vlerësohet si do të duken në praktikë. Për fat të keq jo gjithëherë ndodh kjo. Jo gjithëherë edhe ata që do të jenë të ballafaquar me zbatimin e ligjit në praktikë, ose me pasojat e tij, janë edhe pjesë e ndërtimit të ligjit. Për më tepër, edhe në procesin e amandamentimit të ligjit dhe shqyrtimit të ligjit, te ne praktikohet një praktikë poashtu e mangët. Shpeshherë

dhe në të shumtën qeveria dhe ministrinë përkatëse, sponsorët e ligjit, nuk janë pjesë e amandamentimit të ligjit. Nuk janë madje as pjesë e shqyrtimit në parlament të amandamenteve që propozohen nga deputetët ose komisionet parlamentare. Për pasojë, mund të ndodhë që gjatë amandamentimit të mos të merret shumë parasysh edhe zbatueshmëria e mëtutjeshme e ligjeve. Dhe në vend që të përmirësohen ligjet, ato edhe mund të dëmtohen në segmente të caktuara. Pra, është një praktikë që do të duhej korigjuar edhe me rregullat e procedurës. Qeveria e ka të drejtën dhe është e obliguar, që të jetë pjesë e ndryshimit të ligjit. Ajo duhet të propozojë amandamentet në bazë të diskutimit publik ose debatit në parlament, sepse ajo edhe do të ishte në gjendje më së miri të gjejë zgjidhjet më të zbatueshme në praktikë, që të shohë si duken pastaj zgjidhjet e caktuara gjatë zbatimit të tyre.

Është mirë që në Kuvend ka filluar praktika e dëgjimeve publike, dhe në këtë mënyrë edhe involvimi i të gjithë faktorëve të interesuar për akëcilin ligj në mënyrë që ata të ndihmojnë në cilësinë e ligjeve që do të ishin më të aplikueshme edhe në praktikë. U theksua me të drejtë nevoja e shoqërimit të ligjeve të miratuara me akte përcjellëse, dhe ky është hendikep i madh në legjislacionin tonë. Për më tepër, nuk ka sa duhet ose edhe rrallë ndodhë që ligjet të kenë interpretimin e duhur. Mendoj që këto pengesa bashkë edhe me kulturën demokratike që duhet të ndërtohet më shumë, në të kuptuarit edhe të drejtës dhe të obligimit të parlamentit dhe komisioneve

parlamentare edhe për të mbikëqyruar funksionimin praktik. Mendoj që një ndërlidhje dhe një ndërvarësi funksionale midis ekzekutivit edhe në hartimin e ligjit, edhe në miratimin e ligjit edhe në amandamentimin e ligjit, por më vonë edhe në zbatimin e ligjit dhe plotësimin e ligjit me akte subsidiare është e domosdoshme. Komisioni ynë ka insistuar dhe është angazhuar që ky të jetë një nga drejtimet kryesore të aktivitetit të ardhshëm të komisionit.

ASI: Njëra nga mangësitë është mungesa e ligjeve subsidiare apo akteve nën-ligjore. Tjetra është se në ligje nuk ceken implikimet buxhetore. Çka është duke u bërë në këtë kontekst?

N.Maloku: Kjo është përmirësuar tash disa muaj. Me kërkesë të Kuvendit i kemi kthyer disa ligje që nuk kanë pasur dokumentin përcjellës të implikimeve

buxhetore. Tani çdo ligj që vjen që procedohet në lexim të parë (në seancë plenare), ai vjen edhe me implikime, me shtesën ku prezentohen implikimet buxhetore. Në qoftë se nuk e ka atë pjesë nuk procedohet në kuvend, pra kjo është zgjidhur.

H. Hyseni: Çështja e aspektit buxhetor në legjislacionin që e aprovojmë dhe në ndërtimin e institucioneve që shpesh rezulton nga ligji, është shumë me rëndësi por nuk është e rregulluar. Për shembull, tani kemi në shqyrtim ligjin për gjyqësorin ose për prokurorinë. Një deklaratë financiare edhe mund të bëhet, siç bëhet në disa ligje. Por nëse ajo nuk shqyrtohet me seriozitetin e duhur, si do të duket në praktikë? Pra, përsëri vijmë te çështja e zbatueshmërisë së Ligjit për financa. Kjo shpesh e ka efektin e bumerangut, sepse sa i përket implementimit, del se llogaritë kanë qenë të pabazuara, dhe kështu

Z. Hydajet Hyseni



bëhen pengesë për zbatimin e ndonjë ligji ose ndonjë pjese të ligjit. Për pasojë, ta zëmë në legjislacionin tonë, ka shpesh raste kur ka zgjidhje të mira, por kur vie puna për t'i zbatuar del se puna nuk ka qenë reale, pasi që nuk janë siguruar burimet financiare. Kjo ka ndodhur me kontratën kolektive dhe në disa raste të tjera.

ASI: Si realizohet kontrolli financiar ndaj ministrive përkatëse, në veçanti i shpenzimeve të tyre?

N.Kelmendi: Deri tani nuk kemi hasur në aktivitet në këtë fushë, për shkak se kemi pasur besim të plotë në zyrën e prokurimit publik dhe kemi menduar se ajo është më tepër e thirrur që të kontrollojë shpenzimin e buxhetit. Sidoqoftë, tash e tutje Komisioni do të jetë më aktiv. Edhe nëse nuk do të kërkoj pasqyrë të detajizuar të shpenzimeve së paku do të kërkojmë të jemi të informuar, në përgjithësi, se si

e kanë shpenzuar buxhetin në fazat e caktuara, tre-mujore, gjashtë-mujore, nëntë-mujore, njëvjeçare, e kështu me rradhë.

N. Maloku: Në mandatin e kaluar i kam kërkuar dy herë raport nga Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor për shpenzimet e buxhetit të ministrisë. Kjo, për shkak se në shtyp kishte të dhëna se ka shumë buxhet të pashfrytëzuar, suficit të madh dhe jemi detyruar, pra kemi kërkuar dy herë raport. Më tej nuk kemi shkuar. Ne vetëm kemi kërkuar një raport në vija të trasha se sa buxhet vjetor i është ndarë Ministrisë dhe sa është shpenzuar në departamentet e Ministrisë. Ndonjë kontrollë apo ndonjë hetim tjetër se ku, çka dhe pse është shpenzuar nuk e kemi bërë.

ASI: Pra, kjo do të thotë se nuk ka raport nga auditori gjeneral për shpenzimet e ministrive përkatëse?

Z. Rifat Krasniç



Z. Naim Maloku

N. Maloku: Jo, kemi kërkuar nga ministria. Por nuk kemi shkuar më detajisht në këtë drejtim. Dhe normalisht, sqarimet që i ka dhënë Ministri para Komisionit për shpenzimet.

H.Hyseni: Më parë znj. Kelmendipërmendi Ministrinë e Shërbimeve Publike, ndërsa në opinion kanë dalur të dhëna për veprime të pajustificueshme financiare në menaxhimin e buxhetit, veprime të palejueshme të ministrive. Megjithatë, kjo nuk i bën nder as Kuvendit po as Komisionit poqëse nuk do ta kishte informatën dhe qëndrimin e duhur për çështje të tilla. Si komision, por edhe si Kuvend, ne kemi për obligim mbikëqyrjen e komisioneve tjera, por edhe institucionet e tjera si Qeverinë, zyren e Kryeministrit, Presidencën e Kosovës, edhe kur është fjala për shpenzimet, përfshirë këtu edhe organet e kuvendit si Kryesia, pra në të gjitha këto nivele ku ka indikacione

të bazuara se ka parregullësi. Këto veprime dëmtojnë shumë gjendjen edhe ashtu të rënduar të institucioneve të Kosovës si dhe imazhin e Kosovës.

Për këtë arsye Kuvendi duhet të sigurojë transparencë më të madhe dhe rregullësi më të madhe në funksionimin e institucioneve tona. Institucionet duhet të jenë pasqyra e gjithë shoqërisë dhe duhet të japin shembullin më të mirë të transparencës, të korrektësisë dhe të respektimit të rregullave. E përsëris edhe njëherë duke filluar prej Kuvendit, për mënyrën si udhëhiqet dhe si menaxhohet.

Është e pakuptueshme dhe skandaloze ajo që ndodh ta zëmë me kompleksin 'Gërmia' dhe me involvimin e drejtuesëve dhe administratës së Kuvendit në këtë skandal. Kjo bëhet edhe më skandaloze kur i shohim anëtarët e Kuvendit se si heshtin për këtë çështje. Mendoj se është diçka me të cilën ne duhet të konfrontohemi më seriozisht, me guxim dhe me pjekuri.

Mbikëqyrja efektive parlamentare kundruall tundimeve totalitare

Senatorja Norica Nicolai është anëtare e Partisë Nacional Liberale dhe nënkryetare e Komisionit për Mbrojtje, Rend Publik dhe Siguri Kombëtare të Senatit të Rumunisë dhe njëherit kryeson Nënkomisionin për Siguri dhe Rend Publik. Senatorja Nicolai ishte pjesëmarrëse mjaft aktive në tryezën e rumbullakët parlamentare të Europës Juglindore, që u mbajt në Prishtinë më 5 qershor 2005, duke na shpalosur me këtë rast përvojën postkomuniste të Rumunisë lidhur me mbikëqyrjen parlamentare.

Senatorja Norica Nicolai, Zv. Udhëheqësa e Komisionit për Mbrojtje, Rend Publik, dhe Siguri Kombëtare, Senat i Romanisë

Pas Revolucionit të vitit 1989, Rumania ka përqaftuar demokracinë, duke i hyrë kështu kursit të reformave demokratike. Kushtetuta e parë postkomuniste e vitit 1991 ka përcaktuar bazën ligjore për mbikëqyrjen parlamentare. Së pari, aty është definuar çdo gjë që ka të bëjë me parashtrimin e pyetjeve dhe interpelancave. Ky lloj i kontrollit është shfrytëzuar vazhdimisht nga deputetët për të ngritur çështje të ndryshme për diskutim varësisht nga votuesit që përfaqësonin.

Megjithatë, parashtrimi i pyetjeve dhe interpelancat merren vetëm me mënyrën e menaxhimit të administratës, ndaj nuk bëjnë të mundur iniciimin e ndonjë debati të mirëfillët politik. Pas miratimit të Kushtetutës së re në vitin 2003, ne kemi ndryshuar Rregullorën e Punës së Kuvendit. Unë insistoja në amendamentimin e neneve që kanë të bëjnë me parashtrimin e pyetjeve dhe interpelancat, për t'ju dhënë kështu më tepër kohë, për të rezervuar një ditë për diskutimin e problemeve regjionale, ku duhet të jetë prezent Ministri përkatës, dhe një ditë tjetër të ndahet për opozitën, ngase zëri i opozitës është shumë i rëndësishëm për organizimin e një debati të mirëfilltë. Propozimi im i tretë për përmirësimin e mbikëqyrjes parlamentare kishte të bënte me takimin gjysëm orësh për të diskutuar çështjet urgjente. Kujtoj se një mbikëqyrje e këtyllë e drejtimit të qeverisë

do të ishte më efektiv.

Niveli i dytë i mbikëqyrjes parlamentare sipas Rregullorës së Punës dhe Kushtetutës është kontrolli buxhetor. Kjo është diçka që është prezente në të gjitha kushtetutat. Ne miratojmë buxhetin në seancën plenare në të dy dhomat, pas debatëve të gjata me Komisionin për Buxhet, por jo vetëm me Komisionin për Buxhet. Ndërkaq elementet dhe çështjet e veçanta buxhetore diskutohen paraprakisht në të gjitha 15 komisionet parlamentare. Nganjëherë, derisa njeriu është në pushtet është vështirë të bëjë apo miratojë amendamente. Është pothuajse traditë e sistemit tonë politik që derisa të jemi në pushtet të jemi disi më të 'qetë', në fakt të ndërmarrim më pak iniciativa që do ishin në kundërtënie me propozimet e qeverisë. Ne, normalisht, i miratojmë të gjitha propozimet e qeverisë, ngase në njëfarë mënyre jemi parti e disiplinuar. Mirëpo, do të ishte më mirë që të ushtrohet mbikëqyrje brenda partisë, edhe kur të jesh në pushtet, për t'ju shmangur kështu korrupsionit që paraqet një prej problemeve kryesore.

Një mekanizëm tjetër për mbikëqyrjen parlamentare janë edhe komisionet Hetuese. Shumë komisione të tilla janë krijuar në Rumani pas revolucionit. Mirëpo, mjerisht shumë rekomandime të dala nga këto komisione nuk janë zbatuar. Së këndejmi, dikush edhe mund të vijë në përfun-



dim se komisionet hetuese nuk janë edhe aq efektive. Kjo mund të ndodh për shkak të bie fjala nëse bëjmë një hetim dhe konstatojmë se ndonjë Ministër është implikuar në afëra korruptive dhe Ministri nuk jep dorëheqje dhe madje asnjë veprim tjetër ligjor nuk ndërmerret ndaj tij. Kështu që, kjo i gjason një mbikëqyrjeje 'ceremoniale'. Njëherësh, ne organizojmë shpesh dëgjime, me zyrtarë të lartë përfshirë këtu edhe ministrat, në nivel të komisioneve. Mjerisht, këto dëgjime nuk bëhen gjatë seancave plenare, meqë vazhdimisht na mungon koha për to.

Sidoqoftë, unë mendoj që duhet të gjejmë mënyra më të përshtatshme dhe më efektive për të organizuar dhe ushtruar mbikëqyrje parlamentare për punën e Qeverisë. Ne duhet ta mbajmë qeverinë të përgjegjshme. Ne duhet

t'ua mbikëqyrim sistemin e prokurimit. Duhet të kontrollojmë se si shpenzohen mjetet. Mbase Parlamenti do të duhej të themelonte një komision special për kontroll buxhetor për t'u siguruar që mjetet po shpenzohen konform parimeve të qeverisjes së mirë.

Ma do mendja se ekzistojnë mekanizma më të përshtatshëm kushtetues për mbikëqyrje se sa këto që i ka sistemi ynë. Kushtetuta jonë është hartuar duke u bazuar kryesisht në modele të kushtetutave belge dhe franceze. Unë personalisht preferoj qartësinë e Kushtetutës amerikane, e cila është shumë e drejtëpërdrejtë sa i takon aspektit të mbikëqyrjes parlamentare dhe organeve tjera. Mendoj që nevojitet një lloj i tillë i mbikëqyrjes për të kontrolluar më mirë qeverinë dhe për ta ruajtur

baraspeshën demokratike. Shpesh kjo baraspeshë është e rrezikuar. S'do mend se kur ndodhemi në opozitë, jemi shumë kritik ndaj pozitës, ndonëse, kur jemi në pozitë ne shpesh përdorim metoda të njëjta. Sundimi i ligjit është shumë i rëndësishëm. Ndaj ne duhet që gjithmonë të synojmë baraspeshën demokratike midis Parlamentit dhe Qeverisë, për t'iu shmangur sprovës totalitare kur të jemi në qeveri.

Fjala vjen, Kushtetuta jonë ia ka bërë të mundur Qeverisë që t'a shfrytëzojë të ashtuquajturën "urdhëresën urgjente". Ky lloj i veçantë i akteve ligjore ka qenë i paraparë për situata vërtetë të jashtëzakonshme, që paraqiteshin gjatë kohës kur Parlamenti ishte në pushim. Zakonisht të gjitha ligjet diskutohen në Parlament, por në rrethana të jashtëzakonshme Qeveria merr vendime vetë. Mirëpo, kjo shënon hapin e parë drejt një rregullimi dhe zgjidhjeje të gabuar, një anomalie shoqërore dhe korrupsionit. Do të ishte shumë më me vend sikur Parlamenti të ishte organi i vetëm legjislativ.

Është tejet e rëndësishme që të kemi kontroll të mirëfilltë ndaj sistemit të sigurimit. Sot kemi një sistem të globalizimit ekonomik, por njëherit edhe një sistem global të krizave. Ndaj dhe, sistemi i sigurisë duhet të kontrollohet në mënyrë interne sa më mirë që të jetë e mundur. Në Senatin e Rumanisë ne nuk i mbikëqyrim vetëm strukturat e sigurisë por edhe prokurimin. Kështu që, ekzekutivit i duhet miratimi ynë sa herë që dëshiron të blejë diçka. Është gjithmonë më mirë dhe më demokratike që të kontrollohet ky sistem në nivel parlamentar. Ndaj sa herë që ky parim nuk respektohet, rrezikohet demokracia.

Standardet dhe statusi - rruga përpara

Shkruan Eugen Wollfarth, Shef i Zyrës gjermane në Kosovë.



Gjermania është duke i gndjekur për së afërmi zhvillimet në Kosovë. Si anëtare e grupit të kontaktit ajo në njëfarë mënyrë është pjesë e tyre. Arsyet kryesore për implikim kaq të madh të Gjermanisë në proceset në Kosovë nuk kanë të bëjnë vetëm numrin e madh të kosovarëve që jetojnë në Gjermani por edhe me faktin se ne jemi fqinjë në Evropë. S'do mend se paqja dhe stabiliteti në këtë rajon do të ndikojë në situatën jo vetëm në vendit tonë por edhe në gjithë Unionin Evropian. Ndaj dhe ne jemi të vendosur dhe të përkushtuar për t'i ardhur në ndihmë Kosovës për të zhvilluar dhe rritur ekonominë, për të promovuar punësimin, për të garantuar paqen dhe stabilitetin dhe për të ndërtuar infrastrukturën dhe kapacitetet që do të jenë në dobi të gjithë njerëzve që jetojnë si në Kosovë ashtu edhe rreth saj.

Gjatë kohës kur hartohet Plan i për Implementimin e Standardeve për Kosovën, në vitin 2004, dukej se si Bashkësia Ndërkombëtare ashtu edhe IPVQ-ët do të kalonin nëpër një rrugë mjaft të ndërlikuar dhe të vështirë. Ishte më se e qartë që në fillim se pa përkushtimin e mirëfillt të të gjitha palëve të interesuara do të ishte e pamundur që të arrihej progresi në të tetë standardet. Nga njëra anë askush nuk priste që të 460 detyrat e parashikuara do të plotësohen në tërësi dhe në mënyrë perfekte, pa asnjë vërjetje, por, nga ana tjetër të gjithë besonin se ato të paktën në esencë mund të plotësohen.

Si qëndrojnë punët sot? Për këtë pyetje do të duhej kërkuar zgjidhje nga ambasadori norvegjez në NATO z. Kai Aude, i cili së shpejti do ta publikojë raportin e tij. Por, tani nuk është koha për të spekuluar lidhur me rekomandimet që do t'ia prezantojë Sekretarit të Përgjithshëm Kofi Ananit.

Ndonëse është arritur mjaft progres, megjithatë ka mjaft ngecje, fjala vjen në sferën e kthimit. Një çështje tjetër shumë me rëndësi për proceset në Kosovë është edhe decentralizimi, ndonëse ky koncept nuk përmendet në Planin për Implementimin e Standardeve për Kosovën. Me këtë rast, vlen të theksohet se reformimi i pushtetit lokal është një nga elementet kryesore dhe më të rëndësishme për integrimin e minoriteteve. Ne i kemi mirëpritur disa përparime që janë shënuar tevona, por mbetet ende punë për t'u bërë.

Pa dyshim se Kosova ka bërë përparime në drejtim të


duhur, mirëpo mbetet ende për t'u bërë. Gjatë gjashtë viteve të shkuara si Bashkësia Ndërkombëtare ashtu edhe IPVQ-ët kanë shënuar rezultate të mëdha.

Por, të përiqemi ta hedhim një shikim përpara. Edhe pa topin e kristaltë (për parashikimin e fatit) është më se e qartë se Kosova është pjesë e Evropës. Ndaj dhe Unioni Evropian është tejet i përkushtuar dhe i angazhuar në Kosovë. Gjermania gjithnjë ka konsideruar se standardet janë si mjet për parakualifikim dhe për përafrim më të madh në pragun e përcaktuar nga UE për integrim në këtë institucion. Pikërisht për këtë arsye është e domosdoshme që të vazhdohet me angazhimet dhe përpjekjet për jetësimin e standardeve. Madje edhe pasi të fillojnë bisedimet, ne do të ngulmojmë që të vazhdohet me përparime drejt përmbushjes së standardeve.

Jeta dhe përvoja politike evropiane është jashtëzakonisht inkurajuese dhe interesante. Kështu, nëse ndokush do ta kishte pyetur dike në Francë apo Poloni, gjatë viteve të 40-ta të shekullit të shkuar, nëse është i mundur pajtimi me vendin tim, përgjigja sipas të gjitha gjasave do të ishte pesimiste. Ndërsa, sot ne jemi miqë dhe partnerë në kuadër të UE. Mirëpo, na janë dashur vite të tëra për ta ndërtuar këtë mirëbesim. S'do mend që edhe Kosovës dhe fqinjëve të saj do t'i nevojiten kohë për ta arritur një gjë të këtillë. Ne jemi të bindur se Kosova është dhe do të jetë edhe më tepër një vend në të cilin mund të jetojnë të gjithë qytetarët e saj, pavarësisht nga gjuha që flasin ata.

Zhvillimet e fundit në institucionet e Kosovës

Franklin De Vrieze, OSCE Mission in Kosovo



Presidenti Rugova deklaroi se është i sëmurë nga kanceri i mushkërive

Presidenti i Kosovës Ibrahim Rugova u kthye në Pristinë më 3 shtator pas trajtimit në spitalin ushtarak të SHBA-ve në Gjermani. Më 5 shtator, Dr. Rugova mbajti një fjalim përmes televizionit me ç'rast tha se është i sëmurë nga "kanceri i lokalizuar i mushkërive," por se mjekët e tij ishin të bindur se gjendja e tij do të përmirësohej. Ai nuk dha ndonjë indikacion se do të tërhiqej nga posti i tij i presidentit. Pas fjalimit të tij, anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare, përfshirë PSSP-në Jessen-Petersen dhe përfaqësuesin e lartë të UE-së Javier Solana, lëshuan komunikata në të cilat shprehnin solidarizimin e tyre me Presidentin dhe familjen e tij.

Kuvendi e diskuton bartjen e kompetencave në sektorin e sigurisë

Më 19 korrik, PSSP Søren Jessen-Petersen ia prezantoi kryeministrit Kosumi propozimet e UNMIK-ut për bartjen e kompetencave në fushën e policisë dhe drejtësisë tek IPVQ-të. Në pajtim me këtë propozim, ministrinë e reja për drejtësi dhe punë të brendshme do të krijohen gjatë muajve në vijim. UNMIK-u do të monitorojë dhe vlerësojë punën e ministrive të reja para bartjes së mundshme në fazën e dytë të kompetencave shtesë tek IPVQ-të. Të nesërmen, Kuvendi mbajti një debat të gjerë plenar për sigurinë. Anëtarëve të Kuvendit iu drejtua komisioneri i policisë së UNMIK-ut dhe përfaqësuesi i Shërbimit policor të Kosovës (SHPK). Më 31 gusht, kryesuesi i shtyllës së I-rë, komisioneri i policisë dhe shkolla e SHPK-së e drejtuar nga OSBE-ja kanë bërë një brifing të përbashkët mbi rregulloren e ardhshme për SHPK-në dhe procesin e bartjes së kompetencave në fushën e sigurisë. Shefat e grupeve parla-

mentare, Komisioni për gatishmëri emergjente dhe Komisioni për shërbime publike kanë marrë pjesë në këtë takim. Temat kryesore të bisedimeve përfshinin procedurat e rekrutimit dhe emërimit të oficerëve të policisë, rolin e organeve komunale në vendimmarrje si edhe dispozitat e posaçme që kanë të bëjnë me minoritetet. Më 12 shtator, Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci ia ka transmetuar vërejtjet e konsoliduara të Kuvendit për rregulloren e SHPK-së kryesuesit të shtyllës së I-rë.

OSBE-ja ka qenë e angazhuar në përfshirjen e Kuvendit në diskutime mbi bartjen e kompetencave sa më parë që është e mundur dhe në përkrahje të komisioneve për t'u përgatitur për rolin funksional të mbikëqyrjes së ekzekutivit në fushën e sigurisë. Është arritur pajtimi që OSBE-ja, në bashkëpunim me Qendrën për kontroll demokratik të forcave të armatosura (DCAF) me seli në Gjenevë, të organizojë seminare të ndryshme, tryeza të rrumbullakëta dhe aktivitete të tjera përkrahëse në fushën e mbikëqyrjes parlamentare mbi sigurinë. Pritet që Kuvendi së shpejti të vendosë nëse ndonjë komision i ri apo ndonjë komision ekzistues të ketë përgjegjësinë për sektorin e sigurisë.

Kuvendi mbanë interpelancë për Kryeministrin dhe miraton ligje

Gjatë seancës plenare të Kuvendit të mbajtur më 25 korrik, Kryeministri Kosumi iu përgjigjë një sërë pyetjesh nga opozita, që kryesisht kishin të bënin me akuzat për korrupsion dhe parregullsitë në procedurat e rekrutimit dhe tenderimit nëpër ministri.

Një sërë projektligjesh janë votuar gjatë seancës plenare të korrikut, ndër të cilët më me rëndësi ishin projektligji për trashëgimi kulturore dhe projektligji për transmetuesin publik RTK-në, që të dy të miratuar në leximin e parë. Projektligji për RTK-në u prezantua nga zëvendës kryeministri Adem Salihaj, përkundër parashtrimit të kërkesës nga Komisioni i Kuvendit për shërbime publike dhe media që ai të kthehet prapa për riekzaminim.

Reformat e qeverisjes lokale kalojnë nëpër ujëra të trazuara

Progresi i caktuar në reformën e qeverisjes lokale u bë i qartë nga fundi i korrikut kur PSSP-ja lëshoi udhëzimin administrativ për pilot projektet, që përcakton bazën ligjore për themelimin e njësisë të reja të vetëqeverisjes lokale. Udhëzimi administrativ mundëson themelimin e pesë pilot njësisë komunale brenda pesë komunave ekzistuese.

Më 12 gusht, zëvendës PSSP-ja i parë i nënshkroi pesë vendime ekzekutive duke përcaktuar vijën kufitare të pesë pilot njësisë komunale në Junik, Partesh, Han të Elezit, Graçanicë dhe

Mamushë, dhe kësaj iu referua në mënyrë joformale si “Plani B.” UNMIK-u, kryeministri Kosumi dhe grupi i kontaktit i apeluar serbëve të Kosovës të marin pjesë në proces. Reagimi nga serbët e Kosovës dhe partitë opozitare të shqiptarëve të Kosovës ishte kryesisht negativ. Anëtari serb i Kuvendit të Kosovës pohoi se plani e rezikon ekzistencën e serbëve të Kosovës në zonën e Gjilanit. Sekretari i përgjithshëm i PDK-së tha se plani paraqet “enklavizim” të Kosovës.

Më 23 gusht, grupi parlamentar i SLKM-së njoftoi PSSP-në dhe Kryeministrin e Kosovës me propozimet e veta për ta amandamentuar planin e qeverisë për decentralizim. Pas konsultimeve me liderët lokal në Graçanicë dhe Partesh, SLKM propozoi të rritet proporcioni i popullatës serbe të Kosovës në këto pilot njësi komunale dhe që reforma e vetëqeverisjes lokale të shtrihet në tërë Kosovën.

Në tri nga pesë pilot njësitë komunale progresi mund të vërehet. Mirëpo janë duke vazhduar diskutimet lidhur me përbërjen e dy pilot njësie komunale të mbetura që kanë të bëjnë me serbët dhe rrugën e procesit të decentralizimit në përgjithësi. Më 13 shtator, PSSP-ja nënshkroi tri vendime ekzekutive me të cilat u themeluan Kuvendet e përkohshme në Junik, Mamushë dhe Han të Elezit, dhe u emëruan anëtarët përkatës të Kuvendeve. Sa i përket Parteshit dhe Graçanicës, liderët e serbëve të Kosovës ia prezantuan planin e ri PSSP-së, në mënyrë joformale të njohur si “Plani C”. Sipas planit propozohet ricaktimi i kufinjëve për pilot njësitë komunale të Parteshit dhe Graçanicës me qëllim të krijimit më të qëndrueshem të shumicës me serbë të Kosovës, dhe kërkohet plani i decentralizimit për tërë Kosovën. Ministri i pushtetit lokal Lutfi Haziri e refuzoi “Planin C” si të papranueshëm. Më 16 shtator në Vjenë është mbajtur një takim midis ministrave të pushtetit/administratës lokale, Lutfi Hazirit për Kosovën dhe Zoran Lonçarit për Serbinë dhe Malin e Zi, por ka dështuar zgjidhja e kësaj çështjeje.

Opozita e akuzon qeverinë për korrupsion

Në javën e dytë të shtatorit ka pasur akuza të shtuara për korrupsion kundër Kryeministrit Kosumi dhe qeverisë së tij, me kërkesa për dorëheqjen e tij, dhe duke arritur kulminacionin me parashtrimin e mocionit për interpelancë formale nga një parti opozitare në Kuvendin e Kosovës. PDK-ja ka për qëllim t’i parashtrorë pyetje Kryeministrit për shfrytëzimin e aeroplanit privat me të cilin u kthye në Kosovë pas pushimit në Turqi. Z. Kosumi i ka mohuar keqbjërjet, duke thënë se shfrytëzimi i aeroplanit është ofruar si favor nga Ministri i energjisë dhe minierave Ethem Çeku në mënyrë që z. Kosumi të kthehej me kohë në Kosovë për t’u takuar me të dërguarin e posaçëm Kai Eide. Sipas opozitës, shfrytëzimi i aeroplanit nga z. Kosumi shkel ligjin kundër korrupsionit, sipas të cilit personat zyrtarë nuk mund të pranojnë dhurata në vlerë më të madhe se 50 EUR.



Ambasadori Kai Aide në vizitën e fundit Kosovës dhe Beogradit

I dërguari i posaçëm për Kosovën i Sekretarit të përgjithshëm të KB-ve, Ambasadori Kai Eide, u kthye në Prishtinë për vizitën e tij të tretë dhe të fundit në rajon më 14 gusht. Ambasadori e kaloi pjesën më të madhe të kohës së tij në Prishtinë, dhe u fokusua në çështjet si krimi dhe korrupsioni, marrëdhëniet etnike dhe në vlerësimin e progresit në decentralizim. Në Beograd, z. Eide pati takime me kryetarin e Serbisë, kryeministrin, ministrin e punëve të jashtme, dhe koordinatoren e sapo-emëruar të QKK Sanda Rashkoviç-Iviq. Misionet e kërkimit të fakteve të z. Eide janë përgatitje për publikimin e raportit të tij mbi procesin e demokratizimit të Kosovës.

E ardhmja e Forumit të Kosovës

Forumi i Kosovës, i themeluar me iniciativë të PSSP me qëllim të arritjes së koncenzusit mes liderëve të Kosovës para bisedave për statusin, mbajti takimin e vet të tretë më 21 korrik. Pjesëmarrësit i miratuan projektpropozimet e Sekretariatit të forumit për organizimin e përgatitjeve mbi procesin e ardhshëm për statusin, përfshirë këtu themelimin e pesë grupeve punuese për grumbullin e çështjeve potenciale në këto bisedime: kushtetuese/gjyqësore, ekonomike, çështjet e minoriteteve, të trashëgimisë kulturore dhe personave të pagjetur/dëmeve të luftës.

Sekretariati i Forumit të Kosovës është takuar më 27 korrik dhe ka diskutuar mbi përgatitjet për statusin, rendin e ditës për takimin e ardhshëm të Forumit të Kosovës dhe për gjendjes së sigurisë në Kosovë. Përfaqësuesit e partive vendosën t’i hartojnë kushtet e punës (termat e referencës) për pesë grupet punuese të ekspertëve për të cilat është arritur pajtimi në takimin e mëhershëm të Forumit të Kosovës. Ata gjithashtu u pajtuan që

të përpilohet një listë e anëtarëve të mundshëm vendorë dhe ndërkombëtarë të grupeve punuese.

Gjatë muajit gusht, e ardhmja e Forumit të Kosovës u bë e pasigurtë. Tri takime të forumit janë anuluar për shkak të sëmundjes së presidentit Rugova ose për shkak të mungesës së kryeministrit Kosumi. Kryeministri e ka propozuar themelimin e grupeve punuese përbrenda qeverisë – dhe jo Forumit – për të filluar përgatitjet për statusin. Ai ka propozuar që botuesi i gazetës Zëri të emërohet si koordinator i grupeve punuese.

Më 13 shtator, presidenti Rugova bëri një deklaratë përmes së cilës kërkohej që Kuvendi i Kosovës ta miratoj propozimin e tij për përgatitjet për statusin: z. Shala si koordinator t'i mbikëqyrë grupet punuese të Forumit, dhe që të jetë përgjegjës për "unitetin e ekipit" që përbëhet nga Presidenti i Kosovës Rugova, Kryetari i Kuvendit Daci, Kryeministri Kosumi dhe dy liderët e opozitës Hashim Thaçi (PDK) dhe Veton Surroi (ORA). Z. Rugova gjithashtu propozoi që ky ekip të jetë pjesë e delegacionit të Kosovës për çfarëdo negociatash për statusin në të ardhmen. PSSP-ja ka mirëpritur deklaratën e presidentit dhe njëkohësisht ka vazhduar me presion ndaj partive të shqiptarëve të Kosovës që ato ta gjejnë koncenzusin dhe që së bashku të vazhdojnë përpara. Megjithatë, asnjë nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës nuk ishte përfshirë në "ekipin e unitetit".

Komisioni i Kuvendit kontakton me Zyren e auditorit të përgjithshëm

Pas ftesës së kryesuesit të Komisionit për buxhet dhe financa, z. Naser Osmani, zyra e auditorit të përgjithshëm organizoi një takim njoftues mbi auditimin për Komisionin më 13 shtator. Përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe vendorë të zyrës së auditimit kanë folur për funksionet kryesore të zyrës dhe mënyrat se si zbatohet auditimi. Në veçanti, ata paraqitën auditimet për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës (BKK) për vitet 2002 dhe 2003; shih www.audit-kosovo.org. U tha se Komisioni për buxhet dhe financa mund t'i fillojë diskutimet për BKK 2006 posa të jetë gati projekti për shqyrtim në Këshillin ekonomik fiskal (në fund të tetorit).

Në ndërkohë, përfaqësuesi i ORA-s në Kryesinë e Kuvendit, z. Gazmend Muhaxheri, ka kërkuar qartësime sa i përket mënyrës se si merren vendimet për shpenzimet buxhetore të Kuvendit këtë vit. Në pajtim me ligjin për qasje në dokumente zyrtare, ai ka kërkuar të gjitha dokumentet relevante për shpenzimet financiare të Kuvendit gjatë viteve të fundit si dhe për atë se si u mor vendimi për ndërtimin e Qendrës administrative-protokolare në Gërmi.

Komisioni legjislativ përgatit Ligjin për hetime parlamentare

Komisioni i Kuvendit për çështje ligjore, juridike dhe të kornizës kushtetuese në takimin e mbajtur më 11 prill 2005 vendosi ta iniciojë përgatitjen e mbi Komisionin për hetime parlamentare. Pyetja nëse Kuvendi është kompetent për miratimin

e legjislacionit në këtë fushë u qartësua pas konsultimeve me Zyren ligjore të UNMIK-ut dhe duke e pasur parasysh bartjen e kompetencave në fushat e drejtësisë dhe policisë. Në takimin e vet të mbajtur më 27 qershor 2005 Komisioni legjislativ vendosi ta themelojë grupin punues për përgatitjen e projektligjit, i cili grup përbëhej nga 3 anëtarë të komisionit dhe 13 ekspertë të tjerë. Në takimin e vet konstituiv të 18 korrikut, grupi punues diskutoi për parimet e punës për përgatitjen e projektligjit mbi Komisionin për hetime. Grupi punues e autorizoi z. Virtyt Ibrahimagën, ekspertin ligjor të projektit të financuar nga OSBE-ja "Ngritja e cilësisë së legjislacionit" për ta përgatitur projektin e parë të ligjit deri në shtator të vitit 2005.



Kuvendi e nderon Nënë Tereze

Më 5 shtator 2005, Kuvendi i Kosovës ia kushtoi një mbledhje solemne lumturimit të Nënës Tereze (Gonxhe Bojaxhiu). Në seancën solemne morrën pjesë PSSP-ja Soren Jessen-Petersen, kryetari i Akademisë së arteve dhe shkencave Rexhep Ismajli, ipeshkvi katolik i Kosovës Mark Sopi, komandanti i KFOR-it Giuseppe Valotto, përfaqësuesit e zyrave diplomatike dhe Universitetit të Prishtinës. Si njëri nga biografët më të njohur të Nënë Terezës, dom Lush Gjergji mbajti një fjalim të posaçëm para Kuvendit, gjë që ndodhi me rastin e përvjetorit të 8-të të vdekjes së Nënës Tereze.

Kuvendi vendosë të shkoj tutje me Ligjin për veteranët e luftës dhe viktimat civile

Projektligji për të drejtat e veteranëve të luftës së UÇK-së, familjet e martirëve dhe viktimat civile ka qenë temë e konsultimeve intenzive gjatë muajve të fundit. Më 26 janar 2005, Kuvendi vendosi ta miratojë këtë projektligj në leximin e parë, me kusht që para leximit të dytë grupet parlamentare dhe qeveria t'ie projektligjin. Në letrën drejtuar Kryeministrit më 22 korrik, UNMIK-u kërkoj nga qeveria ta tërheqë projektligjin nga procedura e Kuvendit, ta ridiskutoj atë brenda qeverisë

dhe të largohen mangësitë, të metat dhe brengat ligjore të identifikuar nga UNMIK-u. Deri në fund të gushtit, Komisioni i Kuvendit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale ka vërejtur se ende nuk është arritur qëndrim i përbashkët për disa nga çështjet delikate. Pas konsultimeve të shefave të të gjitha grupeve parlamentare më 2 shtator, Komisioni është takuar më 15 shtator në një seancë të përbashkët me të gjithë shefat e grupeve parlamentare dhe Ministrin e punës dhe mirëqenies sociale. është vendosur që projektligji të shkojë tutje në procedurën e rregullt dhe me qëndrim që ligji të miratohet në seancë plenare sa më parë që të jetë e mundur. Pasi që projektligji merret me një temë shumë të ndijshme, është thënë që duhet të merren parasysh vërejtjet e dhëna nga shumë bashkëbiseduesve. Shpenzimet j ligji vlerësohet të jenë rreth 7.3 milionë euro.

Është zgjidhur kriza në Universitetin e Prishtinës

Kriza për udhëheqjen e Universitetit të Prishtinës (UP) është zgjidhur me udhëzimin administrativ të lëshuar nga Ministri i arsimit, shkencës dhe teknologjisë, Agim Veliu, më 26 korrik. Ky udhëzim administrativ e ka kthyer prapa procesin e implementimit të Statutit të Universitetit të Prishtinës në datën 1 dhjetor 2004 dhe ka mundësuar zgjedhjet e reja për postin e rektorit si dhe themelimin e Bordit menaxhues. Rektori i zgjedhur në mënyrë të paligjshme, profesor Bajrami, ka dhënë dorëheqjen pas disa ditësh përkundër rezistencës fillestare dhe protestave në përkrahje të tij të organizuara nga Unioni i studentëve të UP-së. Përmes një komunikate për shtyp, UNMIK-u e ka mirëpritur nismën e Qeverisë së Kosovës për ta rivendosur qeverisjen e ligjshme në UP dhe ka theksuar se ajo ka vepruar në pajtim me ushtrimin e kompetencave të veta sipas Kornizës kushtetuese.

Ministrat e Kosovës takohen me homologët e tyre nga Beogradi

Më 16 shtator, delegacionet nga Prishtina dhe Beogradi, të përfaqësuar nga Lutfi Haziri, Ministër i pushtetit lokal i IPVQ-ve dhe Zoran Lonçar, Ministër i administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale i Serbisë, u takuan në Vjenë. Serbët e Kosovës iu bashkangjitën delegacionit të Beogradit. Takimi u përqendrua në perspektivën e decentralizimit, protokolinit për të kthyerit dhe qasjen në dokumentet kadastrale. është shprehur përkushtimi për t'u takuar përsëri. Takimi u organizua nga i dërguari i posaçëm i KB-ve për shqyrtimin gjithëpërfshirës Kai Eide, para dorëzimit të raportit të tij Sekretarit të përgjithshëm të KB-ve.

Më 23 shtator, Ministri i kulturës nga IPVQ-të, Astrit Haraqija, dhe Ministri i kulturës i Serbisë, Dragan Kojadinoviq, u takuan në Beograd. Takimi shënoi vizitën e parë zyrtare në Serbi të ndonjë ministri të IPVQ-ve. Ministrat diskutuan për progresin në rindërtimin e kishave ortodokse serbe të dëmtuara gjatë dhunës së marsit të vitit 2004. Që të dy ministrat u pajtuan të



emërojnë koordinatorë kulturor të cilët do të themelojnë grupe punuese në fushat e kthimit të dokumenteve, kthimit të artefakteve, për çështje arkeologjike dhe shkëmbim të përgjithshëm kulturor. Ministri Kojadinoviq e pranoi ftesën e Ministrin Haraqija për një takim tjetër në të ardhmen e afërt.

PDK-ja, partia kryesore opozitare, i ka kundërshtuar këto takime ndërministrare pa miratim paraprak dhe mandat nga Kuvendi i Kosovës.

Kuvendi miraton "Ekipin e unitetit" për bisedat mbi statusin

Gjatë seancës plenare të 28 shtatorit 2005 Kuvendi i Kosovës Ge miratoi propozimin e Presidentit Rugova për "Ekip të unitetit" që do t'i udhëhiqte bisedat për statusin e ardhshëm të Kosovës (shih tekstin e mësipërm). Shefat e grupeve parlamentare të LDK-së, PDK-së, AAK-së, ORA-s dhe 6+ theksuan nevojën që partitë politike të Kosovës të bashkohen dhe të zhvillojnë një qasje të përbashkët për bisedat lidhur me statusin. Shumica e anëtarëve të Kuvendit votuan në favor të propozimit pa vota kundër. Duke e mirëpritur nismën e presidentit Rugova, Veton Surroi (ORA) sugjeroi që Ekipi i unitetit ta diskutojë përbërjen e grupeve punuese dhe për një seancë tjetër plenare të Kuvendit ku do të miratoheshin grupet negociuese dhe platforma e negociatave. Përfaqësuesit e partive më të vogla politike protestuan që nuk ishin të përfshira në konsultime.



Legjislatura I (2001-2004) - Evidenca e Ligjeve të proceduara dhe të miratuara në Kuvendin e Kosovës

Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Data e Miratimit	Rreg.Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
1.	Ligji themelor i pensioneve	Qeveria e Kosovës	2002/1	04.07.2002	2002/15 26.07.2002
2.	Ligji për arsimin Fillor dhe të Mesëm	-/-	2002/2	25.07.2002	2002/19 31.10.2002
3.	Ligji për arsimin e Lartë	-/-	2002/3	25.07.2002	2003/14 12.05.2003
4.	Ligji për Hipotekat	-/-	2002/4	17.10.2002	2002/21 20.12.2002
5.	Ligji për Krijimin e Regjistrave për drejtën Pronës	-/-	2002/5	17.10.2002	2002/22 20.12.2002
6.	Ligji mbi Aktivitetet e Tregtisë me jashtë	-/-	2002/6	08.05.2003	2003/15 12.05.2003
7.	Ligji për Telekomunikacionin	-/-	2002/7	08.05.2003	2003/16 12.05.2003
8.	Ligji për Mbrojtjen e Ambientit	-/-	2002/8	16.01.2003	2003/9 15.04.2003
9.	Ligji për Inspektoratin e Punës	-/-	2002/9	19.12.2002	2003/4 21.02.2003
10.	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike	-/-	2003/2	08.05.2003	2003/17 12.05.2003
11.	Ligji për Pyjet e Kosovës	-/-	2003/3	13.02.2003	2003/6 20.03.2003
12.	Ligji për Likuidimin dhe Riorganizimin e Pers. Jur	-/-	2003/4	13.03.2003	2003/7 14.04.2003
13.	Ligji për Farërat	-/-	2003/5	20.03.2003	2003/10 15.04.2003
14.	Ligji për Bibliotekat	-/-	2003/6	04.04.2003	2003/19 23.06.2003
15.	Ligji për Lëndën Arkivore dhe Arkivat	-/-	2003/7	17.04.2003	2003/20 23.06.2003
16.	Ligji për vendosjen e Tatimit në pronën e paluajt.	-/-	2003/8	7.04.2003	As UNMIK Regulation 2003/29 05.09.2003
17.	Ligji për Kooperativat Bujqësore	-/-	2003/9	15.05.2003	2003/21 23.06.2003
18.	Ligji për Plehrat artificiale	-/-	2003/10	22.05.2003	2003/22 23.06.2003
19.	Ligji për Rrugët	-/-	2003/11	29.05.2003	2003/24 27.06.2003
20.	Ligji për Qasjen në Dokumentet Zyrtare	-/-	2003/12	26.06.2003	2003/32 06.11.2003
21.	Ligji për ndrysh. e plotës. të Ligjit 2002/5 Regjistr. të pronës	-/-	2003/13	26.06.2003	2003/27 18.08.2003
22.	Ligji për Planifikimin Hapësinor	-/-	2003/14	03.07.2003	2003/30 10.09.2003
23.	Ligji për Skemën e Ndhmës Sociale	-/-	2003/15	11.07.2003	2003/28 18.08.2003
24.	Ligji për regjistrimin e popullsisë,ekonom familjare	-/-	2003/16	11.07.2003	2004/53 13.12.2004
25.	Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë	-/-	2003/17	15.01.2004	2004/3 09.02.2004
26.	Ligji për Shërbime Postare	-/-	2003/18	09.10.2003	2003/37 17.12.2003
27.	Ligji për Siguri në punë, mbrojtje të shëndetit e amb.pu	-/-	2003/19	09.10.2003	2003/33 06.11.2003
28.	Ligji për Pesticidet	-/-	2003/20	16.10.2003	2003/35 08.12.2003
29.	Ligji për ndrysh.e plotësim. të Ligjit 2003/2	-/-	2003/21	23.10.2003	2003/38 17.12.2003
30.	Ligji për Inspektoratin Sanitar	-/-	2003/22	06.11.2003	2003/39 17.12.2003
31.	Ligji për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar	-/-	2003/23	06.11.2003	2003/40 17.12.2003
32.	Ligji për Sportin	-/-	2003/24	20.11.2003	2004/26 28.07.2004
33.	Ligji për Kadastër	-/-	2003/25	04.12.2003	2004/4 18.02.2004
34.	Ligji për produktet dhe pajisjet medicinale	-/-	2003/26	04.12.2003	2004/23 07.07.2004
35.	Ligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2004	-/-	2003/27	22.12.2003	As UNMIK Reg. 2003/41 31.12.2003
36.	Ligji për Transport Rrugor	-/-	2004/1	24.03.2005	2005/23 09.05.2005
37.	Ligji për barazi gjinore Kuvendi i Kosovës	Kuvendi	2004/2	19.02.2004	2004/18 07.06.2004

Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Data e Miratimit	Rreg.Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
38.	Ligji kundër Diskriminimit	Qeveria e Kosovës	2004/3	19.02.2004	2004/32 20.08.2004
39.	Ligji për Shëndetësi	-/-	2004/4	19.02.2004	2004/31 20.08.2004
40.	Ligji për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës	-/-		19.02.2004	PSSP + Mocion
41.	Ligji për Tregti me Naftë dhe Derivatet e saja	-/-	2004/5	22.04.2005	2005/22 07.05.2005
42.	Ligji për Transportin e mallrave të rrezikshme	-/-	2004/6	01.04.2004	2004/17 05.06.2004
43.	Ligji për Odën Ekonomike	-/-	2004/7	20.05.2005	2005/30 02.06.2005
44.	Ligji për Energjinë Kuvendi i Kosovës	-/-	2004/8	29.04.2004	2004/21 30.06.2004
45.	Ligji për Rregullatorin e Energjisë	-/-	2004/9	29.04.2004	2004/20 30.06.2004
46.	Ligji për Energjinë Elektrike	-/-	2004/10	29.04.2004	2004/22 30.06.2004
47.	Ligji për Njësitë Matëse	-/-	2004/11	29.04.2004	2004/14 28.05.2004
48.	Ligji për Standardizim	-/-	2004/12	29.04.2004	2004/15 28.05.2004
49.	Ligji për Materialin Fidanor	-/-	2004/13	29.04.2004	2004/16 28.05.2004
50.	Ligji për Marrëveshjet Ndërkombëtare Financiare	-/-	2004/14	06.05.2004	2004/30 09.08.2004
51.	Ligji për Ndërtimin	-/-	2004/15	27.05.200	2004/37 14.10.2004
52.	Ligji për Veprimtaritë Hoteliere dhe Turistike	-/-	2004/16	27.05.2004	2005/6 03.02.2005
53.	Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit	-/-	2004/17	16.06.2004	2004/42 19.10.2004
54.	Ligji për Tregtinë e Brendshme	-/-	2004/18	16.06.2004	2004/43 20.10.2004
55.	Ligji për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve	Kuvendi	2004/19	16.06.2004	2004/25 28.07.2004
56.	Ligji për Tatimin në të Ardhura Personale	Qeveria e Kosovës	2004/20	16.06.2004	Si Rreg. e UNMIK-ut 2004/52 04.12.2004
57.	Ligji për Veterinarinë	-/-	2004/21	16.06.2004	2004/28 30.07.2004
58.	Ligji për Kinematografinë e Kosovës	-/-	2004/22	08.07.2004	2004/38 14.10.2004
59.	Ligji për Tatimin në Fitim	-/-	2004/23	08.07.2004	Si Rreg. e UNMIK-ut 2004/51 04.12.2004
60.	Ligji për Ujërat	-/-	2004/24	08.07.2004	2004/41 14.10.2004
61.	Ligji për detyrimet	-/-	2004/25	28.07.2004	
62.	Ligji për trashëgiminë	Qeveria e Kosovës	2004/26	28.07.2004	2005/7 04.02.2005
63.	Ligji për koncesionet	-/-	2004/27	28.07.2004	
64.	Ligji për punimet nga metalet e çmuara	-/-	2004/28	28.07.2004	2004/33 24.08.2004
65.	Ligji për plot. e ndryshim të Ligjit 2003/3 për pyje	Kuvendi	2004/29	28.07.2004	2004/40 14.10.2004
66.	Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	Qeveria e Kosovës	2004/30	28.07.2004	2004/48 25.11.2004
67.	Ligji për të drejtat sendore	-/-	2004/31	08.09.2004	
68.	Ligji për familjen	-/-	2004/32	08.09.2004	
69.	Ligji për blegtorinë e Kosovës	-/-	2004/33	08.09.2004	2004/39 14.10.2004
70.	Ligji kundër korupcionit	-/-	2004/34	22.04.2005	2005/26 12.05.2005
71.	Ligji për lojërat e fatit	-/-	2004/35	08.09.2004	2005/5 03.02.2005
72.	Ligji për konkurrencën	-/-	2004/36	08.09.2004	2004/44 29.10.2004
73.	Ligji për inspektionin e arsimit të Kosovës	-/-	2004/37	08.09.2004	2004/55 17.12.2004
74.	Ligji për drejtat e përgj. e qytetarëve në kujdes shëndet	-/-	2004/38	08.09.2004	2004/47 19.11.2004
75.	Ligji për shpalljen e kompleksit përkujtimor "Adem Jashari"	Kuvendi	2004/39	08.09.2004	
76.	Ligji për avokatinë	-/-	2004/40	08.09.2004	
77.	Ligji për financimin e partive politike në Kosovë	Qeveria e Kosovës	2004/41	27.09.2004	

Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Data e Miratimit	Rreg.Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
78.	Ligji për veprimtaritë kërkimore-shkencore	-/-	2004/42	27.09.2004	2005/8 23.02.2005
79.	Ligji për tubimet publike	-/-	2004/43	27.09.2004	
80.	Ligji për zejtari	-/-	2004/44	27.09.2004	2005/37 22.07.2005
81.	Ligji për drejtën e autorit dhe të drejtat e afërta	-/-	2004/45	27.09.2004	
82.	Ligji për librin amzë	-/-	2004/46	27.09.2004	2005/21 07.05.2005
83.	Ligji për gazetën zyrtare të Kosovës	-/-	2004/47	27.09.2004	2005/25 12.05.2005
84.	Ligji për administratën tatimore dhe procedurat	-/-	2004/48	27.09.2004	2005/17 09.04.2005
85.	Ligji për patentim	-/-	2004/49	27.09.2004	2004/56 21.12.2004
86.	Ligji për shërbimin privat në shëndetësi	-/-	2004/50	27.09.2004	2005/1 13.01.2005

Kodet

Nr	Emërtimi i Kodit	Sponzorues	Rregullorja Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
1.	Kodi Penal i Kosovës	UNMIK	2003/25 dt.06.07.2003- ndryshimi 2004/19
2.	Kodi i Procedurës Penale	-/-	2003/26 dt.06.07.2003
3.	Kodi Doganor i Kosovës	-/-	2004/1 dt.30.01.2004
4.	Ligji Penal për të Mitur	-/-	2004/8 dt.20.04.2004
5.	Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale	-/-	2004/46 19.11.2004

Legjislatura II (2004-2007) - Evidenca e Ligjeve të proceduara dhe të miratuara në Kuvendin e Kosovës

Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Data e Miratimit	Rreg.Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
1.	Ligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2005	Qeveria e Kosovës	02/L-13	23.02.2005	Si Rreg. e UNMIK-ut 2005/12 01.03.2005
2.	Ligji për plot. e ndrysh.të ligjit 2003/2, për menaxh.financave publike	-/-	02/L-16	23.02.2005	2005/27 17.05.2005
3.	Ligji për verërat	-/-	02/L-8	23.02.2005	
4.	Ligji për lirinë e asociimit në OJQ-të	-/-	02/L-6	23.02.2005	
5.	Ligji për inspektionin e tregut	-/-	02/L-1	23.03.2005	2005/29 31.05.2005
6.	Ligji për mbështetje ndërmarrjeve të vogla e të mesme	-/-	02/L-5	23.03.2005	
7.	Ligji për ujitjen e tokës bujqësore	-/-	02/L-9	23.03.2005	
8.	Ligji për kujdesjen ndaj kafshëve	-/-	02/L-10	23.03.2005	2005/24 09.05.2005
9.	Ligji për teatrin	-/-	02/L-12	23.03.2005	2005/31 08.06.2005
10.	Ligji për produktet e ndërtimit	-/-	02/L-14	23.03.2005	2005/28 17.05.2005
11.	Ligji për mbrojtjen e natyrës	-/-	02/L-18	23.03.2005	
12.	Ligji për komisionin e pavarur të mediave	-/-	02/L-15	21.04.2005	2005/34 08.07.2005
13.	Ligji për shërbimet sociale dhe familjare	-/-	02/L-17	21.04.2005	
14.	Ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve	-/-	02/L-21	20.05.2005	
15.	Ligji për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit	-/-	02/L-20	24.06.2005	2005/36 21.07.2005
16.	Ligji për tokat bujqësore	-/-	02/L-26	24.06.2005	
17.	Ligji për shërbimet e shoqërisë informative	-/-	02/L-23	22.07.2005	
18.	Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur	-/-	02/L-24	22.07.2005	
19.	Ligji për procedurën administrative	-/-	02/L-28	22.07.2005	
20.	Ligji për mbeturina	-/-	02/L-30	22.07.2005	

P/ligjet të cilat janë në procedurë

Nr	Emërtimi i Projektligjit	Propozuesi	Data e pranimi	Dt. Shpërndarjes Deputetëve	Shqyrtimi i Parë	Shqyrtimi i Dytë
1.	Ligji për të drejtat e pjesëtarëve të luftës së UÇK Qeveria e Kosovës	Qeveria e Kosovës	28.12.2004	29.12.2004	26.01.2005	
2.	Ligji për prokurorinë publike	-/-	28.12.2004	29.12.2004	26.01.2005	
3.	Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve	-/-	29.12.2004	29.12.2004	26.01.2005	
4.	Ligji për sigurimet shëndetësore	-/-	29.12.2004	30.12.2004	27.01.2005	
5.	Ligji për banimin	-/-	02.02.2005	03.02.2005	23.02.2005	
6.	Ligji për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës	-/-	15.03.2005	15.03.2005	22.04.2005	
7.	Ligji për taksat gjyqësore	-/-	21.03.2005	21.03.2005	shtyhet	
8.	Ligji për lirinë fetare dhe pozitën juridike të bashk.fetare	-/-	21.04.2005	22.04.2005	20.05.2005	
9.	Ligji për investimet e huaja	-/-	05.05.2005	05.05.2005	24.06.2005	
10.	Ligji për metrologji	-/-	06.05.2005	09.05.2005	24.06.2005	
11.	Ligji për mjekësinë ligjore	-/-	16.05.2005	17.05.2005	shtyhet	
12.	Ligji për duhanin	-/-	16.05.2005	17.05.2005	24.06.2005	
13.	Ligji për përdorimin e gjuhëve	-/-	18.05.2005	18.05.2005	24.06.2005	
14.	Ligji për Inspektoratin shëndetësor	-/-	25.05.2005	25.05.2005	24.06.2005	
15.	Ligji për grevat	-/-	31.05.2005	31.05.2005	24.06.2005	
16.	Ligji për provimin e jurisprudencës	-/-	07.06.2005	07.06.2005	25.07.2005	
17.	Ligji për mbrojtjen nga zjarri	-/-	09.06.2005	09.06.2005	25.07.2005	
18.	Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional	-/-	09.06.2005	09.06.2005	25.07.2005	
19.	Ligji për akreditimin	-/-	09.06.2005	09.06.2005	25.07.2005	
20.	Ligji për procedurën e dhënjës së Koncesioneve	Kuvendi i Kosovës	10.06.2005	10.06.2005	24.06.2005	
21.	Ligji për dizajnimin industrial	Qeveria e Kosovës	15.06.2005	17.06.2005	25.07.2005	
22.	Ligji për trashëgiminë kulturore të Kosovës	-/-	29.06.2005	30.06.2005	25.07.2005	
23.	Ligji për RTK-në	-/-	29.06.2005	30.06.2005	25.07.2005	
24.	Ligji për procedurën përmbarese	-/-	05.07.2005	08.07.2005		
25.	Ligji për ngrohjen qendrore	Kuvendi	06.07.2005	06.07.2005	25.07.2005	
26.	Ligji për kujdesin shëndetësor emergjent	Qeveria e Kosovës	22.07.2005	22.07.2005		
27.	Ligji për veprimtarinë botuese dhe librin	-/-	27.07.2005	28.07.2005		
28.	Ligji për edukimin parashkollor	-/-	27.07.2005	28.07.2005		
29.	Ligji për gjuetinë	-/-	03.08.2005	03.08.2005		
30.	Ligji për markat tregtare	-/-	16.08.2005	18.08.2005		
31.	Ligji për minierat dhe mineralet	-/-	18.08.2005	19.08.2005		
32.	Ligji për ushqimin		14.09.2005	15.09.2005		

Defrim Krasniqi, zyrtar i lartë ligjor, Departamenti për mbështetje juridike dhe procedurale

19.09.2005 Prishtinë

Ligjet e shpalluara mund ti kërkoni në këto adresa : www.kuvendikosoves.org ose në www.unmikonline.org

“Detyra ime është të mos i besoj qeverisë”

Intervistuar nga Edita Buçaj dhe Blerim Vela, Misioni i OSBE-së në Kosovë



Z. Osmani, cili është roli komisionit që drejtoni ju në mbikëqyrjen parlamentare?

N. Osmani: Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka për detyrë që t'i monitorojë shpenzimet e qeverisë dhe t'i raportojë Kuvendit lidhur me to. Njëherit, ky Komision është përgjegjës jo vetëm për kontrollimin e raporteve vjetore dhe periodike por edhe për rishqyrtimin e raportit të financave të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, që kanë të bëjnë me buxhetin e institucioneve të përkohshme duke filluar nga presidenca, Kuvendi, Qeveria e deri te institucionet e tjera.

Kohë pas kohe, ne marim raporte periodike nga Thesari përmes Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për periudhat 3, 6, 9 apo 12 mujore. Të gjitha këto shqyrtohen në Komision. Ndërsa, më pas i analizojmë, i elaborojmë dhe i dërgojmë në Kryesi me propozimin që të përfshihen në rend dite. Tani ne jo vetëm që e kemi përfunduar raportin gjashtëmujor por edhe u kemi shpërndarë një analizë të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Si mund të keni vërejtur nga rendi i ditës, ne kemi kërkuar nga Kryesia që kjo çështje të përfshihet në rendin e ditës për sesionin e ardhshëm. Kështu është parashikuar në Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe kjo njëherit do të bëjë të mundur edhe rritjen e transparencës për shpenzimet periodike të buxhetit.

ASI: A ka pasur raste kur keni vërejtur shkelje dhe shpërputhje midis asaj që është deklaruar dhe asaj që është shkruar në raport?

N. Osmani: Po, ka pasur raste që të kemi shpërputhje midis asaj që është miratuar sipas Ligjit për buxhet dhe arsyetimeve të buxhetit që kanë ardhur nga ministria. E kam fjalën këtu për shpenzimet elementare vjetore. Ne kemi kërkuar sqarime nga Ministri për ate se si ka ndodhur kjo dhe me atë rast secili anëtar i Komisionit ka marrë përgjigjen me shkrim nga Ministria. Në ca raste, ne madje kemi pasur edhe vërejtje lidhur me mënyrën e raportimit, meqë jo të gjithë deputetët janë specialistë të ekonomisë ka të ngjarë që të mos e kuptojnë raportin dot pa u dhënë sqarime të duhura.

ASI: Si e mbani qeverinë përgjegjëse?

N. Osmani: Mënyra e vetme për ta kontrolluar qeverinë është përmes raporteve të Zyrës së Auditorit Gjeneral. Ky institucion është i pavarur gjatë ushtrimit të kontrollit. Megjithatë, unë kam kërkuar që të përmirësohet legjislacioni për këtë institucion në mënyrë që të mund të vendosim një lidhje midis Kuvendit dhe

Zyrës së Auditorit Gjeneral. S'do mend se kjo do të bënte të mundur një bashkëveprim në bazë të sinjaleve tona dhe raportit tonë për Kuvendin përkitazi me punën e tyre, ngaqë ata i raportojnë PSSP-së. Ndërsa, tani për tani ne nuk mund t'ju sugjerojmë që të ushtrojnë kontroll ndaj Presidentit, Kryeministrit apo Doganave.

ASI: Kur është fjala për mbikëqyrjen, ca nga kolegët tuaj kanë pohuar se ata u besojnë ministrive, ndaj dhe nuk kanë dyshuar në raportet e tyre.

N. Osmani: Jo, unë nuk u besoj plotësisht. Mund t'u besoj për disa çështje, por kur është fjala për çështje financiare, ne duhet të jemi gjithnjë të rezervuar dhe të dyshojmë; përndryshe nuk ka arsytim. Thënë figurativisht, unë jam opozita e Ministrit- kur kemi të bëjmë me kryerjen e detyrave. Ndaj unë nuk dëshiroj t'i besoj dhe dua që t'i kem rezervat e mia dhe ta shpreh mosbesimin tim.

ASI: A është Kontrata Kolektive një nga rastet ku ju keni dështuar që të kërkonti përgjegjësi nga Qeveria?

N. Osmani: Unë kam ndërmjetësuar në konfliktin e fundit ndërmjet Sindikatës dhe Qeverisë lidhur me Kontratën dhe kërcënimet me grevë. Ne kemi rënë dakord që ta zbatojnë ate pjesërisht. Nuk e di se kush mund të jetë dakorduar dhe ta ketë nënshkruar ate kur është propozuar. Mbase ka ndikuar ndryshimi në mënyrën e konceptimit të buxhetit, ngase në të shkruarën ne kemi pasur

buxhet me zotime: nënshkruaj sa të mundesh, ngaqë do të paguash kur të mundesh. Ndërkaq, tani është me kesh. Ju shpenzoni ate që e keni. Nuk do të ketë transfer të buxhetit për vitin e ardhshëm. Viti buxhetor fillon me zero, ndaj kjo kontratë me implikime tejet të mëdha buxhetore, që sipas kalkulimeve do të jetë diku afro 70 milionë euro, është e papërbalueshme për buxhetin e Kosovës. Vërjetet tona i kemi bërë të ditura me kohë dhe madje janë bërë vërejtje edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN-ja).

Kontrata Kolektive është rezultat i një marrëveshjeje të mëparshme, të cilën ata tani dëshirojnë ta realizojnë. Mirëpo, kjo po ndodh pikërisht në kohën kur po kemi reduktime të mëdha të buxhetit. Ne madje kemi probleme edhe me sigurimin e minimumit të buxhetit për agjencitë buxhetore që ta bëjmë të mundur kryerjen e detyrave dhe funksionimin e tyre normal. Ju jeni të njohur me situatën në komunë.

ASI: Sa jeni të kënaqur me Ligjin për buxhet për vitin e shkuar, veç kësaj a do të ketë ndonjë ndryshim vitin e ardhshëm, për të përcaktuar bie fjala se sa mjete do të ndahen për paga?

N. Osmani: Ne kemi punuar rreth kornizës afatmesme buxhetore, e cila është miratuar nga Këshilli Ekonomik Fiskal KEF. Korniza parashikon buxhetin për tri vitet e ardhshme. Mjerisht, vitin a ardhshëm 2006, do të kemi reduktim të buxhetit prej 14 milion eurosh. Aktualisht buxheti është 714 milion, pa e llogaritur këtu borxhin prej afro 22 milionësh që i është dhënë KEK-ut dhe Aeroportit. Për vitin 2006 buxheti do të

jetë 700 milionë euro; për vitin 2007 705 milionë, ndërsa për vitin 2008 708 milionë. Prandaj, pas tri vitesh buxheti do të jetë edhe më i vogël se tani.

S'ka pikë dyshimi se ajo që po ashtu e përcakton buxhetin është aktiviteti ekonomik, ngase ne varem krejtësisht nga importi. Kështu që ne kemi një buxhet që shpenzohet. Afro 30% shpenzohen për paga dhe mëditje, por pjesa më e madhe e buxhetit jipet për transfere dhe subvencione, asistencë sociale dhe për mjetet që i ndahen

AKM-së, mbi 80 milion, gjë e cila nuk ka kurrfarë kuptimi, ngase nuk ka vend në botë që i financon kompanitë publike nga buxheti, por zakonisht ndodh e kundërta.

ASI: Në fillim ju theksuat se Komisioni që drejtoni ju ushtron kontroll ndaj të gjitha institucioneve, që harxhojnë paratë e BKK-së. Si qëndron puna me AKM-në?

N.Osmani: Normalisht, se nuk do të duhej t'i financojmë fare. Por, ju mbase dini se ç'janë

kompetencat e rezervuara sa i takon buxhetit. Këtë vit (2005) për herë të parë që buxheti është procesuar përmes Kuvendit. Së këndejmi, mund të themi se kjo është një risi krahasuar me Komisionet e mëparshme dhe një përmirësim në këtë drejtim. Megjithatë, Kuvendi nuk e ka fjalën e fundit. KEF-i [Këshilli Ekonomik Fiskal] është organ më i lartë. Së këtejmi, KEF-i i shqyrton këto çështje, jep propozime dhe mund të bëjë edhe ndryshime të vlerave në buxhet, ndërsa është PSSP-ja

si autoritet përfundimtar, ai i cili e legjitimon ligjin apo buxhetin.

ASI: A e dini, ndoshta nga kolegët tuaj nga mandati i mëhershëm apo edhe gjatë mandatit tuaj, nëse ka pasur ndonjë raport lidhur me shpenzimet e Kuvendit?

N.Osmani: Nuk e di. Por, unë kam kërkuar nga drejtori për financa në administratën e Kuvendit që ta përgatisë për mbledhjen e ardhshme një raport mbi shpenzimet e Kuvendit.

Roli i Misionit të OSBE-së në Kosovë:

Një vështrim mbi të ardhmën e administratës së përkohshme dhe përtej

Kara Johnston-Molina, Zëvendësdrejtoreshë e Zyrës për Çështje Politike- Misioni i OSBE-së në Kosovë

Kosova po ballafaqohet me një sërë vendimesh që kanë të bëjnë me të ardhmën e saj politike dhe ekonomike. Koha për vlerësimin e përgjithshëm të standardeve, që kryesohet nga i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, është afruar. Me këtë rast nuk do të bëhet vetëm vlerësimi teknik i progresit të arritur në Kosovë në përmbushjen e standardeve të demokracisë, por do të bëhet edhe vlerësimi i një procesi më të gjerë politik, që rekomandon fillimin e bisedimeve për statusin.

Pas përfundimit, vlerësimi do t'i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve për t'u diskutuar më pas në Këshillin e Sigurimit të KB. S'do mend se ky vlerësim do të shërbejë si një bazë e mirë për vendimet e Këshillit lidhur me bisedimet mbi statusin. Vlen të vihet në dukje se përfundimet e këtij vlerësimi nuk janë një rezultat që dihet paraprakisht. Kështu që, në rast se raporti, i cili pritet të dorëzohet në fillim të

tetorit, është pozitiv kjo do të mund të sinjalizonte fillimin e bisedimeve për statusin.

Kjo do të thotë se edhe Shtylla e UNMIK-ut për Ndërtimin e Institucioneve, Misioni i OSBE-së në Kosovë duhet të shqyrtojë rolin e vet në të ardhmën si dhe të bëj plane në kontekstin e një sate të padefinuar. Ndaj dhe Misioni duhet që të tregojë fleksibilitet për t'u përballur me sfidat në të ardhmën.

Rezoluta e KB-së 1244 ofron një administrim të përkohshëm përmes së cilës popullata e Kosovës mund të gëzojë një autonomi substanciale, duke mbikëqyrë mes tjerash zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike për vetëqeverisje si dhe duke pritur një zgjidhje politike dhe rezultatin e diskutimeve të ardhshme mbi statusin. Për mandatin e parë UNMIK – u është përgjegjës për ushtrimin etributeve të sovranitetit në Kosovë, dhe duhet të ushtrojë autoritetin e përgjithshëm deri në momentin kur këto të kalohen tek institucionet

vendore pas zgjidhjes së arritur politike.

UNMIK –u nuk mund të shkarkohet tërësisht nga përgjegjësitë e përcaktuara nga Këshilli i Sigurimit, por mund të vazhdojë të luaj rolin e monitorimit, asistimit dhe të ngritjes së kapaciteteve. Ndërkohë që do të vazhdojë një angazhim funksional i IPVQ-ve në fushat e rezervuara dhe akoma nuk do të ketë një ndryshim të Kornizës Kushtetuese.

Si shtyllë e UNMIK-ut, OSBE-ja është konsultuar lidhur me procesin e ristrukturimit në muajin maj dhe qershor të këtij viti. Misioni ka marrë pjesë në Grupin Punues për këtë Çështje, të përbërë nga anëtarë të stafit nga të gjitha shtyllat. Rezultati ishte një sërë rekomandimesh për ndryshime për periudhën para, gjatë dhe pas bisedimeve për statusin. Pra, ky proces ka dalur me një sërë rekomandimesh për UNMIK-un që ta spostojë fokusin e vet në monitorim, asistencë dhe ngritje kapacitetshe. Ky

ndryshim i politikave është i bazuar mbi dy parime kryesore: (1) transfer të mëtutjeshëm të kompetencave që s'kanë të bëjnë me sovranitetin e Institucioneve të Përkohshme, dhe (2) zhvillimin e Politikave të Përgjegjëshme, me pajtimin e plotë të zyrtarëve të IPVQ-ve. Me politikat e përshtetimit të bartjes së përgjegjësisë tek IPVQ-të, do të kemi një involvim më të shtuar operativ në fushat e rezervuara, që do të implementohet kah fundi i vitit 2005.

Pas përfundimit të vitit 2005, brenda kornizës së Rezolutës 1244 pritet që Misioni i OSBE-së të vazhdojë të luajë rol të njëjtë, ndonëse kjo Shtyllë mund të marrë përsipër funksione shtesë dhe se lëmitë ku do të përqendrohet Misioni do të mund të rishqyrtoheshin në dritën e bartjes së vazhdueshme të kompetencave dhe krijimit të ministrive të reja (Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshme), deri në fund të këtij viti. Duke mbajtur parasysh përkushtimin e dëshmuar për një qeveri të përgjegjëshme dhe bartjen e

vazhdueshme të kompetencave tek IPVQ-të, OSBE-ja mund të pritet të luaj një rol akoma më të madh.

Misioni i OSBE-së do të priorizojë mbështetjen për organet e zgjedhura, përgjegjësinë e IPVQ-vbe (apo të pasuesve të tyre) dhe mekanizmat mbikëqyrës, respektimin e standardeve për qeverisje të mirë, të drejta të njeriut dhe multietnicitet, posaçërisht të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur për t'u kthyer. Progami për qeverisjen do të përqëndrohet në transparencë dhe do të monitorojë vendimmarrjen ekzekutive dhe implementimin e politikave. Krijimi i ministrive të reja, të drejtësisë dhe punëve të brendshme, do të shtonte përpjekjet për të fuqizuar mbikëqyrjen ekzekutive, midis të tjerash edhe përmes legjislacionit adekuat. Në përgjithësi, reformimi i pushtetit lokal (decentralizimi) do të nënkuptonte që OSBE-ja të luaj një rol akoma më substancial të monitorimit.

Në vitin 2006, OSBE-ja do të punojë ngushtë me IPVQ-të rreth implementimit të politikave të PSSP-së mbi përgjegjësinë, me ç'rast UNMIK-u do të monitorojë IPVQ-të për t'u siguruar që pushteti është duke u ushtruar me përgjegjësi në fushën e kompetencave të bartura. Sipas kësaj politike, IPVQ-të janë të inkurajuara të ndërmarrin veprime korrigjuese për rastet për të cilat vihen në dijeni – ndërsa UNMIK-u do ta ruajë të drejtën për të intervenuar vetëm në raste të veçanta kur nuk mund të gjindet zgjidhje tjetër. Njëherit, Misioni do të punojë në zhvillimin e politikave proaktive të monitorimit për të siguruar masa parandaluese

dhe 'vetëkorrigjuese' përmes një riorientimi të aktiviteteve të veta dhe një prezence të shtuar në terren.

Së këtejmi, një komponentë e re e aktiviteteve të Misionit do të jenë krijimi i ekipeve komunale për secilën komunë të Kosovës, që do të ndihmojnë në institucionalizimin e praktikave më të mira ekzistuese. Puna e ekipeve do të përfshijë punën me pushtetin lokal për zbatimin e praktikave më të mira demokratike, në veçanti respektimin e procedurave demokratike, konsultimet me opinionin publik, mekanizmat e transparencës dhe ofrimin e barabartë të shërbimeve ndaj komuniteteve dhe të kthyerve.

Sipas një skenari të mundshëm ku bisedat rreth statusit do të mund të fillonin para përfundimit të këtij viti- 2005, si dhe në periudhën pas statusit në Kosovë me një bazë të re ligjore, OSBE-ja mund të marrë rolin kryesor tok me BE-në. Parimet europiane janë forcë shtytëse në qeverisjen e Kosovës. Së këndejmi, Kosova duhet ta vazhdojë rrugën e saj drejt integriteteve europiane, që nënkupton vazhdimin e punës rreth plotësimit të standardeve. Ideali europianë është demokracia e bazuar tek njerëzit dhe tek mosdiskriminimi i tyre. Së këndejmi, vullneti i IPVQ-ve për të ristrukturuar pushtetin me qëllim që të bëjë të mundur trajtimin sa më të drejtë të interesave legjitime të minoriteteve është shumë i rëndësishëm. Sigurisht që vetëm atëherë kur në Kosovë do të zbatohen parimet europiane, mund të ketë shpresë për një bashkëjetesë të njëmendët dhe ndarje efikase të kapaciteteve dhe resurseve vendore, gjë që, njëherit, do të bënte të mundur që Kosova të bëhet pjesë e integruar e familjes europiane.

Sfida për OSBE-në konsiston në atë se ndonëse duhet të përcaktojë një strukturë të re ajo duhet të vazhdojë të mbështesë strukturat e tanishme të prezencës ndërkombëtare, por në të njëjtën kohë duhet të përgatitet për punën dhe detyrat në të ardhmen, të cilat duhet të jenë koherente me strukturën ekzistuese të shtyllës, duke bërë të mundur vazhdimin e punës dhe funksionimit të saj. Sidoqoftë, OSBE-ja do të fokusohet në krijimin e një sistemi demokratik dhe një shoqërie të qëndrueshme multietnike në Kosovë. Integrimi europian

është i lidhur me mandatin tonë të përgjithshëm që ka të bëjë me të drejtat e njeriut, demokracinë dhe ndërtimin e institucioneve. Në këtë aspekt, OSBE-ja është duke i vënë themelet e së ardhmes europiane të Kosovës. Perspektiva europiane është e një rëndësie të veçantë duke mbajtur parasysh se OSBE-ja do të jetë prezente për një kohë më të gjatë për të monitoruar fushat që kanë të bëjnë me standardet, mbrotjen dhe qëndrueshmërinë e multietnicitetit, edhe pas statusit të ardhshëm dhe ekzistimit të Administratës së Përkohëshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.



Grupet punuese për dialog teknik

Nga 20 deri më 23 shtator, forcimi i shkathtësive efektive të negociimit ka qenë në fokus të programit për ndërtimin e kapaciteteve që kishte për qëllim përkrahjen e strukturave të IPVQ-ve të përfshira në dialogun aktual Prishtinë-Beograd. Kjo ngjarje katër ditore për ndërtimin e kapaciteteve ishte e bashkëorganizuar nga Zyra e Kryeministrit dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë, dhe e implementuar nga Qendra për studime të aplikuara në negociata ndërkombëtare (CASIN) me seli në Gjenevë. Grupi i parë i pjesëmarrësve përbëhej nga shërbyesit civil nga Zyra e kryeministrit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe dialog rajonal. Grupi i dytë përbëhej nga anëtarët e grupeve punuese të Kosovës për kthim, persona të zhdukur, energji dhe transport nga dialogu teknik Prishtinë-Beograd. Pjesëmarrësit nga të gjitha komunitetet etnike ishin të pranishëm gjatë programit katër ditor. Njëri nga negociatorët kryesorë të Marrëveshjes së premtës së mirë në Irlandën Veriore e shpali përvojën e tij për probleme të ndryshme me të cilat mund të ballafaqohen negociatorët në fillim të procesit, si dhe rëndësinë e përqendrimit të hershëm në implementimin e çfarëdo marrëveshjeje. Z. Jens Modvig, Zëvendëseshëf i misionit, i konfirmoi planet e Misionit të OSBE-së në Kosovë për përkrahje në shkathtësi të negociimit për ekipin e Kosovës lidhur me bisedat për statusin.

Përputhja e legjislacionit të Kosovës me legjislacionin evropian - EU Acquis Communautaire

Venera Hajrullahu, Drejtoreshë e Zyrës së Proceveve të Integritimit Evropian në Zyrën e Kryeministrit



Zyra e Proceveve të Integritimit Evropian (ZPIE) është themeluar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në qershor të vitit 2004, mbështetur në Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut 2004/18. ZPIE është përgjegjëse për koordinimin e veprimtarisë së qeverisë me qëllim të përshtatjes së praktikave dhe veprimtarisë legjislative me normat dhe standardet relevante të Unionit Evropian (UE), në kuadrin e Procesit të Stabilizimit-Asocimit të UE-së (SAP).

Më saktësisht, Zyra e Proceveve të Integritimit Evropian (ZPIE) është parashikuar të jetë autoriteti kryesor koordinues në fushën e verifikimit të kompatibilitetit kurse, në të ardhmen, i planifikimit adekuat për harmonizimin e legjislacionit. Ndaj dhe roli dhe detyra kryesore e Njesisë për Harmonizimin e Legjislacionit në ZPIE është që t'i zhvillojë procedurat dhe t'a bëjë kontrollimin e harmonizimit me legjislacionin evropian (EU acquis), të marrë pjesë në aktivitetet rreth hartimit të legjislacionit të mbështetur në legjislacionin e UE-së dhe të formulojë dhe japë propozime mbi harmonizimin e legjislacionit vendas me legjislacionin evropian (EU acquis).

Në të vërtetë, sipas Rregullores

së Punës së Qeverisë (RPQ) të datës 05/07/2005 madje edhe kërkohet që harmonizimi me legjislacionin evropian (EU acquis) të sigurohet dhe të bëhet që në fazat e hershme të hartimit të legjislacionit, gjë e cila zakonisht respektohet nga ministritë. Së këndejmi, Zyra e Proceveve të Integritimit Evropian është duke u aftësuar dhe duke i bërë përgatitjet që të veprojnë si "një mik që u vie në ndihmë" atyre institucioneve, të cilët janë të përfshira në procesin e përpilimit të legjislacionit të ri të bazuar në legjislacionin e UE-së. Përpos kësaj, Zyra e Proceveve të Integritimit Evropian (ZPIE) dhe Zyra e Kryeministrit për Mbështetje Ligjore (ZKML) duhet të kenë një bashkëpunim shumë të ngushtë.

Për shkak se si Zyra e Proceveve të Integritimit Evropian (ZPIE) dhe Zyra e Kryeministrit për Mbështetje Ligjore (ZKML) ashtu edhe vetë ministritë janë në një fazë të hershme të funksionimit të tyre, ato ende nuk kanë ekspertizë dhe njohuri të mjaftueshme mbi çështjet e legjislacioni evropian (EU acquis). Prandaj, procesi i verifikimit të pajtueshmërisë është duke u mbështetur nga programet e asistencës teknike, si fjala vjen ata që drejtohen nga AER-i dhe AER/Sofreco, për të bërë të mundur verifikimin e

pajtueshmërisë së legjislacionit të IPVQ-ve. Njëherit, kjo bën të mundur që ekspertët si të Zyrës së Proceveve të Integritimit Evropian (ZPIE) dhe Zyrës së Kryeministrit për Mbështetje Ligjore (ZKML) ashtu edhe të ministrive të mësojnë dhe të fitojnë përvojë në këtë fushë para se t'i marrin tërësisht këto përgjegjësi mbi vete.

Sipas procedurës, para se ndonjë projektligj apo akt tjetër ligjor të mund të dorëzohet për shqyrtim në mbledhjen e qeverisë, Zyra për Integritime Evropiane i ka 15 (pesëmbëdhjetë) ditë të punës për t'u deklaruar dhe për t'a njoftuar Zyrën e Kryeministrit për Mbështetje Ligjore (ZKML) lidhur me pajtueshmërinë e draftit me legjislacionin evropian (EU acquis), prandaj nëse kanëvojë edhe t'a dorëzojë një memorandum ku sqarohen të gjitha ndryshimet për të cilat Zyra e Proceveve të Integritimit Evropian (ZPIE) beson se janë të nevojshme dhe të këshillueshme. Pas pranimit të deklaratës dhe memorandumit, Zyra e Kryeministrit për Mbështetje Ligjore (ZKML) në bashkëpunim me Zyrën e Proceveve të Integritimit Evropian (ZPIE) punojnë rreth përshtatjes së projektligjit, në mënyrë që t'i inkorporojnë vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e Zyrës së Proceveve të Integritimit Evropian (ZPIE).

Që nga marsi 2005, janë verifikuar 35 projektligje nga Zyra e Proceveve të Integritimit Evropian (ZPIE). Tok me Deklaratën për pajtueshmërinë me legjislacionin e UE-së, Zyra e Proceveve të Integritimit Evropian (ZPIE) ka siguruar edhe një memorandum ligjor

ku sqarohen rekomandimet që nevojiten për rritjen e konsistencës me legjislacionin evropian (EU acquis). Megjithatë, ende mbeten problemet e zakonshme siç janë mungesa e njohurive dhe ekspertizës mbi legjislacionin evropian në IPVQ, mungesa e përkthimeve profesionale, cilësore dhe me kohë e legjislacionit të ri dhe në disa raste edhe mungesa e një bashkërendimi më të fuqishëm rreth hartimit të ligjeve.

Për t'i adresuar këto çështje, Zyra e Proceveve të Integritimit Evropian (ZPIE) dhe Zyra e Kryeministrit për Mbështetje Ligjore (ZKML) kanë ndërmarrë tri nisma: 1) krijimin e një baze të të dhënave për ligjet, si një mjet i rëndësishëm në shërbim të procesit të hartimit të legjislacionit; 2) krijimin i një sërë modelesh, që do ta shoqërojnë përgatitjen e projektligjeve në pajtim me kërkesat e RPQ-së; dhe 3) artikullimin e rekomandimeve për prioritetet e Matricës Legjislative 2006. Njëherazi, AER-i ka inicuar një projekt të asistencës për Zyrën e Kryeministrit për Mbështetje Ligjore (ZKML) dhe ministrive, i cili ka për qëllim që t'i aftësojë këto institucione në hartimin e legjislacionit, që është në përputhje me ato të UE-së.

Fare në fund, procesi i përafrimit të legjislacionit kërkon impenjimin e të gjithë akterëve relevantë, të cilët duhet të sigurojnë se ligjet dhe politikat e Kosovës janë në pajtim dhe në harmoni me legjislacionin evropian (EU acquis communautaire). Së këndejmi, pajtueshmëria me legjislacionin evropian jo vetëm që do t'a lehtësojë procesin e reformave ekonomike, sociale dhe të tjera por edhe do t'i vinte në ndihmë angazhimeve dhe përçapjeve të Kosovës në proceset e integritimit evropian.

Përmirësimi i mbikëqyrjes së ekzekutivit në Kosovë

Kuvendi i Kosovës ka shumë mjete të fuqishme për mbikëqyrjen e degës së ekzekutivit dhe implementimin e ligjeve nga kjo degë. Mbikëqyrja efikase është një nga funksionet më të rëndësishme të Kuvendit, dhe duhet të bëhet në seanca plenare dhe, që ndoshta është më me rëndësi, në komisionet përgjegjëse për ministrinë dhe agjencitë e ndryshme. Është mirë e njohur se implementimi i ligjeve në Kosovë mund të jetë më efektiv, por gjithashtu se ka mënyra më të mira për ta shpenzuar buxhetin vjetor. NDI dhe partnerët e tjerë të ASI-t janë të gatshëm ta përkrahin Kuvendin në mënyrë më efektive dhe aktive për ta ushtruar funksionin e vet të mbikëqyrjes.

Edmond Efendija, Instituti Demokratik Kombëtarë (NDI)

Instrumentet e mbikëqyrjes janë në dispozicion si për grupet parlamentare ashtu edhe për deputetët individual, përfshirë këtu edhe ata nga opozita. Këto instrumente u mundësojnë anëtarëve të ngrisin çështje dhe të debatojnë për to në seanca plenare dhe – para opinionit publik – takritikojnë qeverinë. Fatkeqësisht, deri më tash këto instrumente janë shfrytëzuar vetëm në raste të rralla dhe nuk kanë qenë gjithmonë efikase.

Në një përpjekje për ta përmirësuar kuptimin dhe shfrytëzimin e instrumenteve të mbikëqyrjes nga ana e Kuvendit, NDI dhe Bearing Point, në prill të vitit 2005, kanë organizuar një trajnim të përbashkët katër ditor lidhur me mbikëqyrjen e ekzekutivit me secilin grup parlamentar të Kuvendit. Trajnimi u fokusua në komponentat kryesore të mbikëqyrjes së ekzekutivit: implementimin e ligjeve, të udhëhequr nga NDI; dhe mbikëqyrjen e buxhetit vjetor të Kosovës, të udhëhequr nga

Bearing Point.

Implementimi i ligjeve

Trajnimi ka shqyrtuar mekanizmat e ofruar me Kornizën kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Kuvendit, të cilat mund të shfrytëzohen ashtu që ta ndihmojnë Kuvendin në ushtrimin e mbikëqyrjes së duhur legjislativ ndaj ekzekutivit. Derinë momentin e mbajtjes së këtij trajnimi, asnjë pyetje parlamentare nuk i është parashtruar qeverisë së re, asnjë nga komisionet e Kuvendit nuk ka vendosur ta bëjë vlerësimin e zbatimit të çfarëdo ligji nën jurisdiksionin e tyre.

Ndonëse shumë deputetë individual kanë vërejtur se mbetet edhe shumë për t'u bërë lidhur me zbatimin e ligjeve të miratuara, ende nuk shihet sa duhet veprim përbrenda Kuvendit për adresimin e kësaj çështjeje. Në të vërtetë, janë të shumtë ata që pajtohen se puna e komisioneve kryesisht përqendrohet në funksionin e ligjbërjes, ndërsa duhet të bëhet e qartë se, përveç

shqyrtimit të projektligjeve, komisionet duhet të ndajnë kohë edhe për aktivitetet mbikëqyrëse, kryesisht për shqyrtimin e implementimit të ligjeve që janë nën jurisdiksionin e komisionit.

Për t'i ndihmuar deputetët, NDI ka hartuar një doracak me qëllim të ofrimit të informatave për praktikën e mbikëqyrjes në legjislacionet e ndryshme në tërë botën, të cilat mund të përshtaten me rrethanat në Kosovë.

Mbikëqyrja e buxhetit vjetor të Kosovës

Fokusi i secilës ditë trajnuese përbehej nga një orë kohëzgjatje ushtrimi të komisionit parlamentar në rolin e dëgjimeve për përmirësimin e efikasitetit shpenzues të qeverisë. Mbikëqyrja shpesh nënkupton që deputetët duhet të sigurohen që jo vetëm se paratë e tatimpaguesve po shpenzohen në mënyrë ligjore, por edhe ekonomike. Prezentimi nga Bearing Point ka treguar që Qeveria gjatë periudhës aq të përfolur të dhjetorit 2004 ka shpenzuar

në mënyrë të ligjshme, ndonëse ka patur mundësi të jetë ca më ekonomike.

Komisioni Buxhetor luan rolin kryesor në mbikëqyrjen buxhetore. Me amendamentimet e fundit në Kuvend sipas Rregullorës së Punës, raportet financiare të dorëzuara nga qeveria duhet shqyrtuar brenda komisionit dhe debatuar në seancën plenare.

Përfundim

Duke i vështruar seancat e fundit plenare po vërehen disa sinjale vërtetë premtuese. Jemi dëshmitarë të shumë pyetjeve parashtruar ministrave të qeverisë, më shumë kërkesa nga opozita për të debatuar çështje në seanca plenare, dhe kjo jep arsye më shumë për të besuar që Kuvendi po ndërmerr hapat e vet në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes. Akoma shumë ngelet për të bërë, por është shenjë e mirë kur shohim deputetët që ndërmarrin masa mbikëqyrëse, ngase siç thotë një fjalë e urtë popullore 'më mirë të ndizet qiriri, sesa të mallkohet terri'.



Mbikëqyrja parlamentare e Ministrisë së re të Punëve të Brendshme

“Kuvendi duhet të kujdeset që shqetësimet, opinionet dhe pikëpamjet e shoqërisë, të kuptohen, adresohen dhe shqyrtohen si duhet.”

“Policia është gjithnjë politikisht neutrale, ndaj dhe emërimet, avansimet dhe gradimet politike nuk lejohen.”

Peter Vanhoutte, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Brenda disa javësh, do të themelohet Ministria për Punë të Brendshme. Policia do të jenë pjesa më e rëndësishme e transferit të kompetencave nga UNMIK-u tek Qeveria e Kosovës. Që nga fillimi, policia duhet të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve, dhe nën përgjegjësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Një mbikëqyrje e vazhdueshme parlamentare është e domosdoshme për të garantuar që këto struktura policore të jenë pjesë përbërëse e një sistemi efektiv demokratik.

Përgjegjësi

Në shoqëritë demokratike, shërbimet policore u japin llogaritë tri degëve qeverisëse: legjislativ (Kuvendit), ekzekutiv (Qeverisë) dhe gjyqësor (Gjykatave). Qeveria ushtron kontroll direkt nga niveli qendror dhe lokal dhe përcakton buxhetin, udhëzimet e përgjithshme dhe prioritetet për policinë. Legjislativi ushtron mbikëqyrjen parlamentare përmes miratimit dhe shqyrtimit të ligjeve që definojnë dhe rregullojnë veprimtarinë dhe kompetencat e shërbimeve policore dhe duke miratuar buxhetin e nevojshëm. Policia i përgjigjet ministrave përkatës, ndërsa ministrat nga ana tjetër i japin llogari Kuvendit. Metodot themelore të mbikëqyrjes parlamentare

janë parashtrimi i pyetjeve, interpelancat dhe mocionet, organizimi i debateve, dëgjimet publike dhe vizitat, kontrolli buxhetor dhe shqyrtimi i legjislacionit ekzistues.

Një marrëdhënie efektive

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes efektive të policisë, Kuvendi dhe Qeveria duhet të luajnë role të ndryshme, ndonëse që të dyjat janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e punës në sektorin e sigurisë. S’do mend se për të arritur këtë, Kuvendi jo vetëm që duhet të ushtrojë kontroll mbi qeverinë dhe policinë, por njëherazi duhet ta thellojë bashkëpunimin dhe krijojë marrëdhënie të ngushta, të bazuara në mirëkuptim të ndërsjellë, me të dy këto institucione.

Vendosja e marrëdhënieve të mirëfillëta të mbikëqyrjes mes Kuvendit dhe Policisë bazohet mbi një sërë parimesh. Në një shoqëri demokratike, autoritetet shtetërore (apo në Kosovë kuazi ekuivalentët e tyre) kanë monopolin legjitim mbi forcën. Kjo nënkupton që përveç policisë askush tjetër, as qytetarët, kompanitë private të sigurimit, organizatat paramilitare etj nuk kanë të drejtë që t’a drejtojnë armën kundër bashkëqytetarëve.

Është më se e qartë se policia drejtpërsëdrejti është përgjegjëse ndaj autoriteteve legjitime demokratike, para së gjithash ndaj Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ndërsa, Kuvendi mban Qeverinë përgjegjëse për zhvillimin e politikave policore dhe për mbikëqyrjen ejetësimi të këtyre politikave. S’do mend se mjeti më efektiv për një gjë të tillë është buxheti. Kuvendi miraton dhe kontrollon buxhetin dhe shpenzimet e policisë.

Politikisht neutrale

Meqë deputetët e Kuvendit konsiderohen si veshët dhe sytë e qytetarëve, ata duhet të sigurojnë gjatë gjithë kohës që policia t’i respektojë në tërësi dhe t’u përmbahet me përpikëri parimeve të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit. Megjithatë, me përjashtim të komisioneve hulumtuese, shërbyesit civil (fjala vjen oficerët e policisë) askurrë nuk mund të jenë drejtpërsëdrejti përgjegjës ndaj Kuvendit. Ndaj, individualisht oficerët e policisë dhe shërbyesit civil, në rast të shkeljes së ligjit, përgjigjen para gjykatave. Qeveria, në përgjithësi dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Kuvendi, në veçanti duhet ta kenë të qartë se policia demokratike është dhe duhet të jetë gjithnjë neutrale. Së këtëjmi, emërimet, avansimet dhe gradimet politike nuk

lejohen.

Përveç mbikëqyrjes së rregullt parlamentare, ekziston nevoja edhe për struktura të jashtme shtesë të mbikëqyrjes. Ato struktura janë Ombudspersoni dhe Komisioni për Peticione, të cilat mund t’i hetojnë dhe shqyrtojnë ankesat e qytetarëve. Pa dyshim se organet e drejtësisë duhet t’a monitorojnë policinë dhe t’i ndëshkojnë të gjitha shkeljet e policisë përmes procedurave penale dhe për kundërvajtje, saherë që një gjë e tillë është



e nevojshme. Njëherit, është me rëndësi që në çdo kohë të sigurohet një ndarje e saktë, e plotë dhe e qartë midis gjyqësorit, ekzekutivit dhe legjislativit.

Krijimi i politikave policore

Krijimi i një politike gjithëpërfshirëse policore është pjesë përbërëse e politikës globale për siguri, që përfshinë të gjithë akterët dhe aspektet relevante të sigurisë. S'ka pikë dyshimi se kjo politikë policore duhet të jetë në përputhje me ndonjë nga politikat e krijuara nga akterët e tjerë (ndërkombëtarë). Sa i takon Kuvendit, debati mbi sigurinë është pjesë e procesit dhe përbëhet nga katër faza: zhvillimi, vendim-marrja, implementimi dhe vlerësimi.

Kuvendi luan një rol të kufizuar në fazën e krijimit të politikave policore. Kjo detyrë i takon kryesisht Qeverisë. Megjithatë, Kuvendi në anën tjetër do të mund të jipte kontributin e tij duke i shqyrtuar shqetësimet e qytetarëve dhe duke i adresuar ato që nga fillimi. Së këndejmi, Komisioni për Siguri/Polici duhet të informohet nga Qeveria mbi zhvillimet e politikave qysh në fazën e hershme të planifikimit, në mënyrë që të jetë në gjendje të reagojë në mënyrën e duhur.

Kuvendi mund dhe duhet të luaj rol të rëndësishëm gjatë fazës së vendim-marrjes, veçanërisht kur është fjala për policinë, dokumentet dhe legjislacionin për politikat e sigurisë. Kuvendi mbase edhe mund ta jap pëlqimin e tij për politikat dhe ligjet

e propozuara nga Qeveria. Mirëpo, ka të ngjarë që Kuvendi shpeshherë do të propozojë ndryshime, të cilat pastaj do të bëjnë të mundur nxjerrjen e një dokumenti me pëlqim dhe miratim të gjerë. Po kështu, gjatë fazës së vendim-marrjes, Kuvendi do ta ketë fjalën kryesore përmes alokimit buxhetor.

Më vonë, gjatë shqyrtimit të shpenzimeve, Komisioni mund të vlerësojë ndikimin që ka pasur politika e miratuar dhe të marrë parasysh këtë gjatë diskutimit për buxhetin e vitit të ardhshëm.

Mbështetja e opinionit publik

S'do mend se Kuvendi është akteri kryesor sa i takon rritjes së përkrahjes së opinionit publik dhe sigurimit të legjitimitetit të politikave të miratuara. Ndaj, transparencë në këtë nivel është tejet e rëndësishme. Kështu që, debatet duhet të jenë sa më publike. Veç kësaj, rendi i ditës për mbledhjet e ardhshme të Kuvendit duhet bërë publike me kohë. Po kështu, të gjithë deputetët duhet të pajisen me rendin e ditës dhe dokumentacionin përgatitor sa më herët që është e mundur, apo së paku një ditë para takimit.

Kuvendi duhet të kujdeset që shqetësimet, opinionet dhe pikëpamjet e shoqërisë, të kuptohen, adresohen dhe shqyrtohen si duhet. Meqë deputetët nuk kanë gjithmonë kohë të mjaftueshme për të bërë analiza të duhura për perceptimet e qytetarëve, institucionet e pavarura dhe OJQ-të vendore mund të luajnë rol të rëndësishëm në përfaqësimin e zërit të qytetarëve.



Instrumentet parlamentar për mbikëqyrjen e punës së ekzekutivit

Virtyt Ibrahimaga, LL.M. Ekspert i lartë ligjor dhe këshilltar ligjorë i Kuvendit të Kosovës

“Demokracia është qeverisja nga popullit dhe për popullin” (Abraham Lincoln).

Ky është parimi i demokracisë sipas ideatorëve të saj. Populli zgjedh institucionet që ushtrojnë pushtetin në emër të tyre në zgjedhje të lira. Pushteti në sistemet demokratike është i ndarë në pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Ndarja e pushteteve ka për qëllim evitimin e koncentrimin të pushtetit në një organ të vetëm dhe kështu vënien nën kontroll reciprok të pushtetit. Në parim këto pushtete janë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të saj. Megjithatë ato i nënshtrohet mbikëqyrjes ndërsjellë. Ky kontroll siguron rruajtjen në duart e sovranit nga dhe pengon marrjen e pushtetit nga një organ tjetër. Kështu Qeveria përcakton politikën, Kuvendi miraton ato dhe i kodifikon në ligje dhe gjyqësori e përkujdeset se ato ligje aplikohen dhe interpretohen në atë frymë që janë miratuar pa favorizim të ndonjë pale. Njëra ndër kontrollet klasike të pushtetit është mbikëqyrja parlamentare, tematike e cila do të trajtohet në këtë artikull me fokus të veçantë për instrumentet e këtij funksioni. Parlamenti përveç detyrës në nxjerrjen e ligjeve, ka edhe funksionin e dytë klasik që është mbikëqyrja e ekzekutivit. Kjo detyrë nuk është e përcaktuar në mënyrë eksplicite në Kornizën Kushtetuese. Megjithatë, duke u nisur nga parimet e demokratike dhe duke u bazuar në praktikën e të gjitha parlamenteve demokratike në

botë, është parim i pranuar se parlamenti krahas nxjerrjes së legjislativitetit i ka një detyrë tjetër shumë esenciale, që ka të bëjë me kontrollin dhe mbikëqyrjen e ekzekutivit. Mbikëqyrja e ekzekutivit ka për qëllim rritjen e efikasitetit të ushtrimit të pushtetit dhe krijimi e bilancit në mes të pushteteve. Në demokracitë e vjetra evropiane kjo detyrë ushtrohet qysh nga themelimi i parlamenteve demokratike. Me qëllim të ushtrimit me efikas të kësaj detyre parlamentet janë të pajisura me instrumente të ndryshëm kontrolli. Këto instrumente kryesisht janë të rregulluar me rregulloret interne të parlamenteve. Rregullorja e re e Punës së Kuvendit gjithashtu është e pajisur me instrumente të tillë të sprovuar në praktikën e parlamenteve evropiane. Këto instrumente do të shtjellohen në këtë artikull me qëllim të informimit sa më të qartë lidhur me qëllimin dhe përdorimin e tyre. Është me rëndësi të theksohet se instrumentet e parapara me Rregulloren e Punës për ushtrimin e mbikëqyrjes parlamentare i nënshtrohen procedurave të fikse. Procedurat kanë për qëllim të sigurojnë se këto instrumente janë përdorur për qëllime për të cilat ato janë krijuar.

1. Pyetjet dhe Përgjigjet

Seancat parlamentare janë njëra ndër instrumentet e pergjithshme ku debatohet për politikën dhe veprimet e qeverisë. Përveç mundësisë së radhës se debateve në rend të ditës së Kuvendit që kanë

të bëjnë punën e ekzekutivit, deputetet kanë mundësi që gjatë seancës së rregullt parlamentare të shtrojnë pyetjet e tyre specifike qeverise brenda periudhës së përcaktuar për seancën e pyetjeve dhe përgjigjeve. Seanca e pyetjeve dhe përgjigjeve ka të bëjë me informimin e Kuvendit lidhur me çështjet specifike shoqërore dhe politike. Pyetje parlamentare mund të behet sipas Rregullës 26 me gojë ose me shkrim nga çdo deputet. Pyetjet duhen të përpilohen me shkrim dhe ti dorëzohen zyrës për parashtrëse së paku 5 ditë para datës së përcaktuar për mbajtjen e seancës plenare. Qeveria përkatësisht ministrat janë të obliguar që ti ofrojnë deputetëve përgjigjen në seancë plenare. Kryesia mund të vendosë të refuzoj pyetjen vetëm në rast se pyetja nuk është parashtruar sipas rregullave të rregullores së punës së Kuvendit. Sa i përket diskresionit të Kryesisë duhet të theksohet se Kryesia mund të shqyrtoj lejueshmërinë e pyetjes vetëm nga ana procedurale.

a. Pyetjet e deputetëve

Pyetjet e deputetëve dallojnë në mes të pyetjeve joformale dhe formale. Pyetjet joformale janë pyetje spontane që bëhen gjatë seancës së Kuvendit në kuadër të debatit për një temë të caktuar, të cilave Ministrat ose Kryeministri nuk janë të detyruar ti përgjigjen, nëse ata nuk e konsiderojnë të nevojshme. Ndërsa pyetjet formale për Qeverinë janë, pyetje me shkrim të drejtuara Qeverisë nga deputetët. Pyetjet

mund të kërkohen për përgjigje me gojë dhe me shkrim. Çdo deputet ka të drejtë të shtroj pyetje Qeverisë. Pyetjet formale shtrohen me shkrim dhe i dërgohen Kryesisë së Kuvendit, e cila ia përcjell Ministrat ose Kryeministrat pyetjen. Kryesia e Kuvendit mund të refuzoj pyetjen, nëse ajo nuk është bërë në përputhje me procedurën e paraparë me rregulloren e punës.

Kryesia e Kuvendit nuk mund ta refuzoj pyetjen për shkak të përmbajtjes së saj. Megjithatë, pyetja nuk guxon të përmbaj elemente fyese ndaj personalitetit të ministrit, ndaj ndonjë partie ose komuniteti. Për më tepër ajo duhet të jetë konkrete dhe të ndërlidhet me një veprim ose mosveprim të caktuar të ekzekutivit, në kuadër të përgjegjësisë së saj. Sipas praktikës së shteteve të Evropës perëndimore kontinentale, në formën e pyetjes shtrohen temat konkrete për një çështje të veçantë, kryesisht temat lokale dhe rajonale. Në disa shtete, sikur Gjermania pyetjet për Qeverinë quhen edhe pyetje të vogla, ngase trajtojnë një çështje konkrete dhe praktike. Pra çështjet e ndërlikuara politike shtrohen përmes instrumenteve tjerë që do të prezantohen më poshtë. Qeveria mund të refuzoj të deklarohet ndaj pyetjes së deputetit me njoftim paraprak. Në këtë rast qeveria duhet të arsyetojë me shkrim vendimin e saj. Në këtë rast, pyetja dhe vendimi për refuzim publikohen në buletin e Kuvendit të Kosovës. Me kërkesë të një



grupi parlamentar ose 5 % (6 deputet) të anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi mund të vendosë që Ministri përkatës ose Kryeministri ti përgjigjen pyetjes së deputetit. Procedura e Rregullues 26.1 aplikohet në këtë rast.

Pyetjet e parashtruara për përgjigje me gojë mund të përgjigjen vetëm gojarisht. Pyetjet e deputetëve mund të parashtrihen dhe përgjigje me shkrim parashtruara për përgjigje me shkrim mund të përgjigjen me shkrim. Procedura e parashtrimin të përgjigjeve me gojë vlen e për përgjigjet e kërkuara me shkrim.

b. Seanca e pyetjeve dhe përgjigjeve.

Pyetjet për Qeverinë mund të shtrohen në do seancë të rregullt plenare, të enjten ndërmjet 14 dhe 16 . Seanca e rregullta të Kuvendit mbahen zakonisht javën e fundit të muajit duke filluar nga dita e mërkurë. Pyetjet zakonisht duhen të shtrohen 5 ditë para seancës plenare. Megjithatë Kryetari i Kuvendit mund të vendosë që të lejohet pyetjen nëse deputeti ka kërkuar se paku 2 ore përpara me shkrim nga Kryetari i Kuvendit dhe anëtari përkatës i qeverisë për

përgjigje në pyetjen e caktuar, ose në rast se Kryetari i Kuvendit konsideron se pyetja është e natyrës së ngutshme. Pasi të lexohet pyetja, anëtari i qeverisë i përgjigjet pyetjes së deputetit. Deputeti që ka parashtruar pyetjen ka të drejtë të beje pyetje shtesë. Pyetja shtesë duhet të ndërlihet me pyetjen e parë. Pyetja shtesë nuk mund të zgjatë me tepër se 2 minuta dhe përgjigja nuk zgjatë më tepër se 5 minuta. Pas kësaj lejohet që deputeti të shtrohet edhe një pyetje shtesë për të cilën deputeti ka vetëm një minutë dhe anëtari i qeverisë vetëm 2 minuta për përgjigje. Ky kufizim ka për qëllim që të drejtoj seancën e pyetjeve në atë drejtim për të cilin ky instrument është krijuar .

2. Interpelanca

Interpelanca shërben për informimin e parlamentit lidhur me një veprim ose ngjarje nga ana e qeverisë që ka nxitur një interesim të madh publik. Pra, për ndryshim nga pyetjet, interpelanca shërben për qëllim të shtimit të problemeve me rëndësi të veçantë politike. Vet fakti se për interpelancën nevojitet mbështetja e më së paku 10 deputetëve dëshmon për faktin se interpelanca nuk

mund të shtrohet për çështje që nuk janë me interes të veçantë politik i cili është në interes të një rrethi të konsiderueshëm politik. Interpelanca duhet të dërgohet Kryesisë me shkrim, e cila menjëherë ia drejton Qeverisë. Qeveria duhet të deklarohet brenda 15 lidhur me kërkesën. Dhjetë ditë nga data e përgjigjes së Qeverisë, interpelanca duhet të shtrohet në rend të ditës së Kuvendit. Nëse Qeveria nuk përgjigjet brenda 10 ditësh, interpelanca vihet në rendin e ditës së seancës plenare që zhvillohet si pike e fundit e rendit të ditës. Sikur edhe me ne rastin e pyetjeve, Kryesia mund ta shqyrtoj kërkesën për interpelancë vetëm nga aspekti formal procedural dhe jo nga aspekti përmbajtësor. Nga aspekti formal interpelanca përveç mbështetjes së 10 deputetëve duhet të jetë shtruar për vetëm një çështje të caktuar, këtë të formuluar qartë çështjen që shtrohet, të përmbajë një propozim konkluzion dhe arsyetimin për të si dhe të evidentohet emri dhe nënshkrimi i propozuesit si dhe mbështetësve të interpelancës. Arsyetimi duhet të përmbajë fakte apo të dhëna që e mbështetin propozim konkluzionin. Propozimkonkluz

ka të beje vetëm me vërtetimin e një fakti dhe nuk mund të përmbajë elemente të vendimit apo të rekomandimit. Pra ajo nuk mund të ngërthejë në vete ndonjë kërkesë konsekuencë juridike ose politike, përndryshe ajo mund të refuzohet për mangësi formale. Konkluzat vetëm ka të bëjë me konkludimin e një fakti i cili ka të beje me çështjen e interpelancës. Nëse propozuesi dëshiron që konkludimi lidhur me faktin të mbështetet nga Kuvendi, atëherë konkluzat duhet të jetë e bazuar në fakte të cilat iu janë bashkangjitur arsyetimit. Përndryshe i tërë debati mbi çështjen nuk do të sjell fryt, përveç një ballafaqimi politik. Ballafaqimet politike nuk duhen të jenë motiv për interpelancë. Ballafaqimet politike përmbajtësore zënë vend të debate mbi çështjet që shtrohen si pike e rendit të ditës. Interpelancat duhen të shtrohen vetëm për një ngjarje me rëndësi të veçantë politike ku nga qeveria kërkohet informim lidhur me çështjen. Interpelanca mbaron me votimin mbi propozimkonkluzionin e parashtruesit. Për këtë arsye është me rëndësi që kërkesa të jetë e përpiluar dhe arsyetuar mirë, në mënyrë që të mund të arrij efektin e saj. Është me rëndësi të theksohet se konkluzioni në rast se ka sukses nuk ka asnjë relevante juridike ose konsekuencë politike, përveç nëse ajo kërkohet si rezultat i konkludimeve të kuvendit nga interpelanca përmes mjeteve të tjera përcaktuara me rregulloren e punës. Në rast se Qeveria refuzon interpelancën Kuvendi, me vendim mund të detyroj qeverinë të vijë në

seance sipas procedurës të paraparë me Rregullën 26.1.

3. Pjesëmarrja e obligueshme e Ministrit ne seance plenare

Një instrument tjetër më i rreptë i ushtrimit të mbikëqyrjes parlamentare është prezenca e detyrueshme e kryeministrit ose ministrit në seancë plenare. Për ndryshim nga mjetet e tjerë të prezantuar më lartë, ky mjet nuk i nënshtrohet asnjë barriere formale përveç asaj të një kuromi të caktuar. Sipas Rregullës 26.1, një grup parlamentar ose 5 % të anëtarëve të Kuvendit mund të kërkojnë që një anëtarë i qeverise të marre pjese ne mbledhjen e Kuvendit. Kjo kërkesë mund të shtrohet edhe gjatë seancës plenare. Për kërkesën vendosë Kuvendi me shumicë të thjeshte votash. Në rast se kërkesa përkrahet nga shumica e thjeshte e Kuvendit, Ministri ose Kryeministri duhen të vijnë në seancën plenare. Ne këtë rast ndërprerët puna e Kuvendit deri sa Ministri ose Kryeministri të vije në punimet e Kuvendit. Megjithatë mundësia që të ftohet urgjentisht një anëtarë i qeverise ne Seance Plenare mund të behet vetëm për çështjet që janë te shtruara ne rend dite. Për çështjet e tjera duhet të aplikohet procedura e rregullt e parapare me Rregulloren e punës. Nëse kemi të bëjmë me një çështje urgjente atëherë aplikohen dispozitat për agjendën e Kuvendit. Pjesëmarrja në seancë plenare e Ministrit ose Kryeministrit është e detyrueshme. Pjesëmarrja nuk nënkupton vetëm prezencën e tyre pasive. Kryeministri ose Ministri përkatës është i detyruar të informoj Kuvendin

lidhur më çështjet dhe pyjet që shtrohen në seancë. Edhe komisionet parlamentare janë të autorizuar që të thërrasin qeverinë të marrë pjese ne mbledhjen e komisionit.

4. Komisioni hetimor

Komisionet parlamentare hetimore janë mjete të rëndësishme për mbikëqyrjen parlamentare të ekzekutivit dhe për mbledhjen e informacionit për çështje të rëndësishme me interes publik. Ngritja e një komisioni hetimor ka për qëllim ndriçimin e një rasti i cili konsiderohet të jetë i një rëndësie te veçante për publikun. Komisioni parlamentar heton rastin e caktuar dhe bien përfundime te cilat i prezantohen Kuvendit. Komisioni hetimor parlamentar kryesisht ngritët për rastet kur konsiderohet se çështja e caktuar nuk ndriçohet përmes pyetjeve dhe përgjigjeve ose interpelancës parlamentare. Sipas Rregullës 59, Kuvendi mund të vendose që për një çështje te caktuar të ngrit një komision hetimor. Procedura e ngritje se komisionit hetimor nuk është e paraparë me rregulloren e punës. Gjatë hartimit të rregullores se punës dhe në pajtim me praktiken e sistemeve parlamentare kjo procedure rregullohet me një akt te veçante juridik.

5. Mocioni konstruktivi mosbesimit

Mocioni i mosbesimit është i vetmi instrument i kontrollit i cili mund të sjelle me vete një konsekuence direkte politike ose juridike. Kuvendi mund t'ia shprehe qeverise mosbesimin, vetëm nëse njëkohësisht arrin të zgjedh kryeministrin dhe qeverinë e re. Pra kërkesa për mosbesim duhet te përmbajë

edhe propozimin për qeveri te re. Kërkesa për mosbesim të qeverise ekzistuese dhe votëbesim të qeverisës re votohen me një vote te vetme . Nëse Kuvendi e mbështetë kërkesën, Qeveria e re me kryeministrin e propozuar ne krye e zëvendëson qeverinë e deritashme. Nëse propozimi hedhet poshtë, qeveria dhe kryeministri i tanishëm vazhdon punën. Instrumente tjerë për shkarkimin e Qeverise, përveç është atij te shpërndarjes së Kuvendit nuk parasheh rregullorja e punës se Kuvendit. Mocioni i mosbesimit mund të shtrohet nga 30 deputet. Nga aspekti formal kërkesa duhet ti përmbajë nënshkrimet e 30 deputeteve dhe emrat e kandidateve për Kryeministër dhe ministra. Kjo kërkesë si tersi hedhet ne votim. Kryetari i Kosovës nuk ka asnjë rol ne këtë procedure. Nëse mocioni mbështetet nga shumica e deputetëve të Kuvendit, qeveria e merr mandatin për periudhën e mbetur te legjislaturës.

6. Vlerësim

Sikur që u vërejt edhe nga prezantimin e gjertanishëm, mbikëqyrja parlamentare është funksion i pashmangshëm i demokracisë moderne dhe paraqet garantin për ndarjen dhe balancimin e pushteteve. Mbikëqyrja parlamentare eviton mundësinë e keqpërdorimit të pushtetit qeverisës, paraqet një forme sanksionimi politik të veprimeve joligjore dhe jolegjitime dhe ndikon pozitivisht në transparencën e punës se organeve shtetërore. Megjithatë, ushtrimi i mbikëqyrjes parlamentare

mund të keqpërdorët nga ana e deputetëve ose grupacioneve për qëllime vetjake politike që nuk kanë të bëjnë me interesat e sovranit (popullit). Keqpërdorimi i këtij funksioni është shumë i dëmshmen për zhvillime demokratike në një vendi dhe për kredibilitetin e një parlamenti dhe politikës në përgjithësi. Gjatë ushtrimit të këtij funksioni duhet pasur parashydhë legjitimitetin e parlamentit dhe çdo deputeti ne veçanti. Mandati i tyre shtrihet në përfaqësimin e interesave të popullit dhe jo përfitimit personal ose partiak. Me qëllim ushtrimit të drejtë të këtij funksioni, rregullorja e punës parasheh instrumente përmes të cilave mund të ushtrohet kjo detyre e rëndësishme demokratike. Është shumë me rëndësi që procedurat për shfrytëzimin e këtyre instrumenteve të respektohen nga çdo deputet dhe çdo organ tjetër i Kuvendit dhe Qeverisë dhe të aplikohen konform qëllimit të tyre. Është gjithashtu me rëndësi që të vlerësohet paraprakisht nga deputetet se cili nga këto instrumente i përshatet me se mire çështjes e cila duhet te shtrohet. Vetëm ne këtë mënyre ushtrimi i mbikëqyrjes mund te jete efikas. Duhet me evitohen rastet ku përmes këtyre instrumenteve tentohet te hapet debat politik për një tematike te caktuar politike. Debatit politik duhet të koncentrohet në kuadër debateve për çështje te caktuar. Ne këtë mënyre edhe ruhet efikasiteti i punës se kuvendit. Ne te njëjtën kohe është me rëndësi që deputetet të ketë mundësinë e pakufizuar ti shfrytëzojnë instrumentet e parapare.

Mbikëqyrja e Ekzekutivit të Komunës nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Silvia Eckert, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Sistemi i mbikëqyrjes së ekzekutivit dhe i kontrollit dhe balancit midis ekzekutivit dhe legjislativit nuk është një koncept i ri. Rrënjët e këtij koncepti mund të gjinden tek politikani dhe filozofi francez Charles de Montesquieu, i cili i pari kishte dalur me idenë për ndarjen e pushtetit qeverisjes në tri degë ate të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, në librin e tij të mirënjohur, Rreth Frymës së Ligjit (On the Spirit of Law). Montesquieu-u besonte se ndarja e pushtetit në tri degë do të bënte të mundur që pushteti të mos përqëndrohet vetëm te një grup apo individ dhe që secila degë do t'i kufizonte dy të tjerat. Dokumenti kryesor ligjor për institucionet komunale është Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, e cila shërben si bazë për statuset e komunave.

Sistemi i kontrollit dhe balancit në praktikë

Shumica e draft rregulloreve për komunat inicoheh nga ekzekutivi dhe përfshihen në rend dite për diskutim në nënkomisionet e specializuara të Kuvendit Komunal (KK), siç janë ato të shëndetësisë, planifikim urban, dhe arsimit. Diskutimet aktuale të politikave dhe rregulloreve zhvillohen para se t'i përcillen Bordit të Drejtorëve, Komisionit për Politika dhe Financa dhe në fund Kuvendit Komunal për miratim. Për ndryshe, komisionet e specializuara mund po ashtu të inicojnë rregullore, por kjo rrallëherë ndodh. Juristi komunal i Gjilanit konfirmoi se " identifikimi i nevojave, hartimi dhe implementimi i rregulloreve

dhe politikave të komunës janë kompetencë e ekzekutivit të komunës, ngase shërbyesit civil merren me këto udhëzime për çdo ditë". Njëherit, Kuvendi Komunal është përgjegjës për miratimin përfundimtar të raporteve periodike të punës së departamenteve të komunës; kjo zakonisht bëhet pa ndonjë diskutim apo pa vërejtje të mëdha.

Megjithatë, për shkak të situatës politike në Kuvendin Komunal të Gjilanit, (LDK-ja i ka 22 vende nga 41 vendet), ku një parti e ka vetëm shumicën e thjeshtë, qeveris dhe nuk ka nevojë për koalicion, diskutimet dhe debatet në sesionet e KK-së nuk janë kundërthënëse, ndaj rezultatet e votimit janë të parashikueshme. Së këndejmi, Kuvendit Komunal në vend që ta ushtrojë në mënyrë kritike funksionin mbikëqyrës të administratës roli i tij në të vërtetë është reduktuar në miratimin e raporteve të punës, projekt-rregulloreve dhe politikave ashtu si propozohen nga ekzekutivi, të cilat më pas ndryshohen dhe amendohen në komisionet përkatëse.

Përqëndrimi i pushtetit të ekzekutivit

Ekziston një trend i akumulimit të pushtetit nga ana e ekzekutivit dhe kështu mendon jo vetëm lideri i partisë opozitare PDK-së në Gjilan por edhe të tjerët. Është interesant se edhe kryetari i Kuvendit Komunal, z. Xhemal Hyseni po ashtu ka vërejtur një tendencë të ngjashme të akumulimit të pushtetit në administratë. Sipas tij, administrata qendrore- në mesin e tyre edhe Ministria e Pushtetit Lokal, që drejtohet

nga ish kryetari i Kuvendit të Gjilanit Lutfi Haziri- kërkon më shumë hapësirë gjatë bashkëveprimit midis ministrive në Prishtinë dhe komunës së Gjilanit dhe njëherit vuri në dukje se ministrinë janë të prira që çështjet t'i rregullojë nga niveli qendror dhe t'u japin urdhëra komunave, duke ua kufizuar atyre hapësirën për veprim. Veç kësaj, shefi i ekzekutivit i ushtron kompetencat për të lëshuar urdhëresa administrative, fjala vjen për miratimin e planit për zhvillim ekonomik të komunës, një dokument ky me rëndësi afatgjatë për komunën, pa e konsultuar Kuvendin Komunal apo publikun. Me këtë rast, madje edhe Montesquieu-u do të pajtohej se kuvendi dhe ekzekutivi aktualisht kanë shumë pushtet.

Emërimet politike në ekzekutiv – Qeveria "me një zgjedhje"

Anëtarëtepartiveopozitare,nga njëra anë, në veçanti PDK-ja si partia më e madhe opozitare në Gjilan me 13 vende, janë ankuar lidhur me emërimet politike në ekzekutiv, ndërsa LDK-ja, nga ana tjetër, nuk e mohon një gjë të tillë. Zakonisht zyrtarët e ekzekutivit emërohen në bazë të orientimeve (përkatësisë) të tyre politike. Në të gjitha demokracitë ekziston praktika që emërimet e zyrtarëve të lartë të ekzekutivit/ shërbyesve civil politik bëhen në bazë të përkatësisë së tyre partiake, respektivisht partisë që e ka shumicën si në Kuvendin qendror ashtu edhe ate komunal, ndaj as Gjilani nuk është përjashtim: Që të dyja si legjislativi ashtu edhe

ekzekutivi janë të dominuara nga mbështetësit apo delegatët e LDK-ës, pra është qeveri komunale "me një zgjedhje". Ndonëse shërbyesit civil të komunës në të shumtën e rasteve janë njerëz kompetentë, megjithatë duke i emëruar në administratë mbështetësit e besueshëm dhe lojal të partisë ekziston rreziku që kjo praktikë ta kompromentoj qëllimin për të siguruar një shërbim sa më profesional.

Publiku si dega e katërt

Komuna e Gjilanit ka ndërmarrë ca masa për ta implikuar një akter tjetër në sistemin e kontrollit dhe balancit, duke ua bërë të mundur kështu qytetarëve që të marrin pjesë në mënyrë të haptë në procesin e vendimmarrjes, gjë e cila do të bëjë të mundur edhe rritjen e transparencës. Së këndejmi, në vitin 2003 KK-ja ka miratuar një rregullore sipas së cilës duhet të konsultohet opinioni i qytetarëve përmes dëgjimeve publike para se një rregullore të diskutohet në Kuvendin Komunal. Mirëpo, pjesëmarrja në mbledhjet publike është mjaft e ulët. Roli i kryetarit të KK-së si përfaqësues i të gjithë qytetarëve të komunës së Gjilanit duhet të fuqizohet, pavarësisht nga përkatësia partiake apo etnike, çka do të ishte në të mirën e gjithë komunës. Për ta bërë rolin mbikëqyrës të Kuvendit Komunal plotësisht funksional dhe për ta neutralizuar dhe balancuar ekzekutivin, që është mjaft i fuqishëm, delegatët e KK-së lipset që jo vetëm të jenë të informuar mirë por edhe të angazhohen me një profesionalizëm tejet të lartë.



Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqendrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respektimin e rregullave demokratike të punës, transaprencës dhe përgjegjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legjislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respektin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevojat në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinator i ASI-it Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregullt i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

Anëtarët të tanishëm të ASI-t:

Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti I praktikave Parlamentare Lindje Perëndim (EWPPP), Agjensioni Europian për Rindërtim (EAR), Agjensioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Instituti Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërpametarn (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.



Këshilli redaktues:

Sven Lindholm, Ramush Tahiri, Franklin De Vrieze, Blerim Vela, Labinot Hoxha, Edmond Efendija, Krenar Loshi.

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
kontakt: franklin.devrieze@osce.org
<http://www.osce.org/kosovo>

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij buletini : OSBE-ja: fq. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 17, 19/
Gazeta Express: fq. 9, 12 (Ermal Meta) /
fq. 10, 11, 21, 22, 23, 27 (Astrit Ibrahim).